



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Harta e Stabilitetit Financiar të Kosovës

Krenare MALOKU BAKIJA dhe Arben MUSTAFA

Material Studimor Nr. 6

Material Studimor i BQK-së Nr. 6

Harta e Stabilitetit Financiar të Kosovës

Krenare Maloku Bakija dhe Arben Mustafa¹

Abstrakt

Monitorimi sistematik i stabilitetit financiar është një ndër funksionet kyçe të bankave qendrore, rëndësia e të cilit është rritur sidomos pas krizës financiare të vitit 2008 për shkak të kompleksitetit të sektorit si dhe efekteve të krizës financiare në sektorët e tjerë të ekonomisë. Ky material studimor zhvillon modelin e Hartës së Stabilitetit Financiar (HSF) për Kosovën, si vegël analitike shtesë për monitorimin dhe vlerësimin e stabilitetit financiar. Harta synon të prezantoj në mënyrë grafike dhe lehtësisht të kuptueshme burimet kryesore të rreziqeve të jashtme dhe të brendshme ndaj sektorit bankar dhe stabilitetit financiar në Kosovë, si dhe ndryshimin e tyre gjatë disa periudhave kohore. Kontributi i HSF-së qëndron në mundësimin e analizimit të njëkohshëm të aspekteve të ndryshme të brishtësive dhe rreziqeve ndaj stabilitetit financiar, duke ruajtur njëkohësisht karakteristikën e gjithëpërfshirjes dhe paraqitjes së agreguar të rrezikut ndaj stabilitetit financiar. Rezultatet e modelit, i cili përfshinë tetë aspekte të rrezikut të ndërtuara nga një bazë e gjerë e nëntreguesve kuantitativ të komplementuar me gjykim profesional, sugjerojnë për trend rënës të rrezikut të përgjithshëm ndaj sektorit bankar në Kosovë të ndikuar kryesisht nga pozita e mirë e kapitalizimit dhe profitabilitetit, përmirësimi i strukturës së sektorit, si dhe rreziku i ulët nga ekonomia e jashtme.

JEL klasifikimi: E32, E44, E58, G21,

Fjalët kyçe: stabiliteti financiar, sektori bankar, vlerësimi i rreziqeve bankare, harta e stabilitetit, Kosova

Nëntor 2016

¹ Pikëpamjet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë pikëpamjet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Autorët dëshirojnë të falënderojnë bashkëpunëtorët Taulant Sylja, Arta Nushi, Bejtush Këçmari dhe Valon Hasanaj për kontributin e çmueshëm në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe komentet dhe mbështetjen për punimin. Adresa e korrespondencës: krenare.maloku@bqk-kos.org.

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	7
II. Rishikimi i Literaturës	8
1. Modelet e hartave të stabilitetit dhe aplikimi i tyre	10
III. Metodologjia e ndërtimit të HSF-së për Kosovën	13
IV. Ndërtimi i treguesve dhe nëntreguesve përkatës	15
1. Ekonomia e jashtme	15
1.1. Norma e rritjes reale të Bruto Produktit Vendor të partnerëve kryesorë tregtarë	15
1.2. Norma e ponderuar e papunësisë e vendeve me numër më të madh të diasporës kosovare	15
1.3. Çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare	16
1.4. Indeksi kryesor i përbërë i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD Composite Leading Indicators: OECD Europe)	16
1.5. Norma mesatare e LIBOR dhe EURIBOR 3-mujorë	16
2. Ekonomia e brendshme	17
2.1. Hendeku i prodhimit	17
2.2. Madhësia e borxhit të jashtëm	17
2.3. Bilanci i llogarisë rrjedhëse	17
2.4. Lulahshmëria e kursit të këmbimit	18
2.5. Indeksi i çmimeve të konsumit – Inflacioni	18
2.6. Kualiteti i institucioneve gjyqësore	18
3. Ekonomitë familjare	19
3.1. Huamarrja e ekonomive familjare	19
3.2. Cilësia e portofolit kreditor të ekonomive familjare	19
3.3. Norma e papunësisë	20
3.4. Dërgesat e emigrantëve	20
3.5. Përbalueshmëria e pagesave të rregullta	20
4. Ndërmarrjet	20
4.1. Huamarrja e ndërmarrjeve	20
4.2. Cilësia e portofolit kreditor të ndërmarrjeve	21
4.3. Indeksi i qarkullimit industrial	21
4.4. Vlera e shtuar në sektorin e tregtisë	21
4.5. Ecuria e ndërmarrjeve të reja dhe të mbyllura	22
5. Qeveria	22
5.1. Madhësia e borxhit publik	22

5.2. Kostoja e borxhit publik	23
5.3. Rreziku sovran	23
5.4. Bilanci buxhetor i qeverisë	23
5.5. Të ardhurat tatimore	23
6. Struktura e sektorit bankar	24
6.1. Koncentrimi i tregut të sektorit bankar	24
6.2. Koncentrimi i kredihënies për sektorin e ndërmarrjeve	24
6.3. Devijimi i strukturës së kreditimit të bankave ndaj strukturës së tregut	25
6.4. Devijimi i strukturës së fondeve të bankave ndaj strukturës së tregut	25
6.5. Devijimi i normës së kapitalizimit të bankave ndaj normës së kapitalizimit të gjithsej sektorit	26
7. Kapitalizimi dhe profitabiliteti i sektorit bankar	26
7.1. Mjaftueshmëria e kapitalit rregullativ	26
7.2. Kapitali aksionar i sektorit	27
7.3. Kreditë joperformuese të sektorit	27
7.4. Të ardhurat neto nga interesi	27
7.5. Profitabiliteti i sektorit	27
7.6. Ekspozimet e mëdha	27
8. Likuiditeti dhe Financimi	28
8.1. Mbulueshmëria e kredive me depozita	28
8.2. Depozitat e ekonomive familjare	28
8.3. Detyrimet ndaj jo-rezidentëve	29
8.4. Raporti i likuiditetit	29
8.5. Hendeku i likuiditetit	29
V. Performanca e treguesve të mesatarizuar	31
V.I. Agregimi i treguesve të mesatarizuar të HSF-së	36
VI. Harta e Stabilitetit – Paraqitja grafike	37
VII. Përfundim	40
11. Referencat	42

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Dimensionet e rrezikut të HSF-së në Kosovë-----	15
Figura 2. Ekonomia e jashtme-----	33
Figura 3. Ekonomia e brendshme -----	33
Figura 4. Ekonomitë familjare -----	34
Figura 5. Ndërmarrjet-----	34
Figura 6. Qeveria -----	35
Figura 7. Struktura e sektorit bankar-----	35
Figura 8. Kapitalizimi dhe profitabiliteti -----	36
Figura 9. Likuiditeti dhe financimi -----	36
Figura 10. Mesatarja e thjeshtë e treguesve të mesatarizuar -----	38
Figura 11.A. Harta e stabilitetit financiar -----	39
Figura 11.B. HSF-ja në periudhën e krizës globale financiare -----	40

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Nëntreguesit dhe metodologjia e ndërtimit të tyre-----	49
------------------------------------------------------------------	----

I. Hyrje

Monitorimi sistematik i stabilitetit financiar është një ndër funksionet kyçe të bankave qendrore, rëndësia e të cilit është rritur sidomos pas krizës financiare të vitit 2008 për shkak të kompleksitetit të sektorit si dhe efekteve të krizës financiare në sektorët e tjerë të ekonomisë. Pothuajse të gjitha bankat qendrore monitorojnë në vazhdimësi rreziqet ndaj stabilitetit financiar dhe publikojnë raporte të ndryshme periodike mbi këto zhvillime.

Qasje dhe metoda të ndryshme narrative dhe numerike janë përdorur nga bankat për të vlerësuar brishtësitë dhe rreziqet ndaj stabilitetit financiar. Në vitin 2007, Fondi Monetar Ndërkombëtar ka ndërtuar një metodë të re të vlerësimit, e cila është motivuar kryesisht nga fokusi i shtuar në nivel global mbi rreziqet e stabilitetit financiar si pasojë e rritjes së kompleksitetit të faktorëve të cilët ndikojnë në jostabilitet, pasojave të rënda të jostabilitetit eventual në ekonomi, si dhe mungesës së metodave adekuate për monitorimin e këtyre rreziqeve (Dattels et al., 2010). Metoda e Hartës Globale të Stabilitetit Financiar është ndërtuar me idenë për të interpretuar kushtet e stabilitetit financiar dhe rreziqet ndaj tij në mënyrë grafike, si dhe për të qenë më gjithëpërfshirëse në aspektin e analizimit të faktorëve dhe burimeve potenciale të jostabilitetit dhe efekteve përcjellëse/ndërlidhëse ndërmjet segmenteve të ndryshme të tregjeve financiare.

Modeli i Hartës Globale të Stabilitetit Financiar të FMN-së ka përparësinë që mund të zgjerohet në përfshirjen e aspekteve të ndryshme të rrezikut si dhe mund të përshtatet për të vlerësuar rreziqet në nivel të shteteve. Shumë vende tashmë kanë zhvilluar modelin e tyre të Hartës së Stabilitetit Financiar (HSF), të cilës i japin vend qendror në vlerësimin e kushteve dhe rreziqeve ndaj stabilitetit financiar dhe komunikimin e tyre për publikun.² Duke u bazuar në modelin bazë të FMN-së, si dhe në metodologjitë e bankave tjera, është ndërtuar modeli i Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës i cili prezantohet në këtë punim.

Punimi është strukturuar në shtatë seksione: Seksioni i dytë përfshinë rishikimin e literaturës për modelet e shfrytëzuara për vlerësimin e stabilitetit financiar dhe arsyeshmërinë për zhvillimin e Hartës së Stabilitetit Financiar. Seksioni i tretë përshkruan metodologjinë e përdorur për ndërtimin e HSF-së në Kosovë. Seksioni i katërt shpjegon treguesit dhe nëntreguesit e HSF-së. Seksioni i pestë diskuton performancën e treguesve të mesatarizuar në kohë. Seksioni i gjashtë paraqet HSF-në në mënyrë grafike për periudhat e fundit dhe ato të krizës financiare globale. Seksioni i shtatë paraqet një përmbledhje të punimit dhe thekson kufizimet dhe rekomandimet për punën në të ardhmen.

² Banka Qendrore e Zelandës së Re (Bedford dhe Bloor, 2009); Banka e Norvegjisë (Dahl et al., 2011); Banka e Shqipërisë (Saqe et al., 2015); Banka e Latvisë (Lielkalne dhe Sinenko, 2015).

II. Rishikimi i Literaturës

Vlerësimi i stabilitetit financiar është sfidues për shkak të kompleksitetit të ndërveprimit të elementeve të ndryshme të sektorit financiar mes vete dhe me elemente të jashtme të ekonomisë reale. Përvoja e shumë vendeve të botës ka dëshmuar kompleksitetin e këtyre ndërlidhjeve, si dhe ka theksuar rëndësinë për vlerësimin dhe monitorimin sistematik të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar për shkak të pasojave negative që mund të barten nga sektori financiar në ekonominë reale dhe anasjelltas.

Për më shumë se dy dekada, studiues të ndryshëm të fushës dhe hulumtues nga bankat qendrore të vendeve të ndryshme kanë bërë përpjekje për të prezantuar kushtet dhe rreziqet ndaj stabilitetit financiar përmes ndërtimit të treguesve të ndryshëm, krahas vlerësimit narrativ të faktorëve të ndryshëm të rrezikut. Ndër metodat më të hershme janë ato të cilat kanë vlerësuar segmente të veçanta të sektorit financiar, bazuar në të dhëna nga bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave të institucioneve financiare. Treguesit e Shëndetit Financiar, të zhvilluar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në vitin 2001,³ i përkasin kësaj kategorie të metodave. Ata përfshijnë 40 indikatorë që synojnë të vlerësojnë shëndetin e sektorit financiar të shtetit përkatës përmes vlerësimit të qëndrueshmërisë së institucioneve të tij financiare dhe sektorit të korporatave dhe ekonomive familjare. Megjithëse ende mjaft të popullarizuara për vlerësimin e zhvillimeve të sektorit, Treguesit e Shëndetit Financiar në përgjithësi nuk konsiderohen si të mjaftueshëm dhe gjithëpërfshirës në vlerësimin e stabilitetit financiar, kryesisht për shkak se janë numër i madh i indikatorëve të cilët shpesh japin sinjale kontradiktore, si dhe për shkak të mungesës së kufijve krahasues për vlerësimin e rrezikut (Lielkalne dhe Sinenko, 2015; Dahl et al., 2011).

Vlerësimi i stresit financiar në segmente të caktuara të tregut financiar është bërë edhe përmes metodave të ashtuquajtura Sisteme të Sinjalizimit të Hershëm. Përmes specifikacioneve ekonometrike, studiues të shumtë kanë përdorur variabla të ndryshme, të cilësuar si indikatorë të sinjalizimit të hershëm, për të parashikuar krizat bankare, krizat e valutave apo krizat e borxhit. Goldstein, Kaminsky dhe Reinhart (2000) zhvilluan sistemin e sinjalizimit të hershëm të krizës së valutave dhe krizës bankare për vendet në zhvillim. Roli i indikatorëve të ndryshëm në sinjalizimin e krizave u testua edhe nga shumë studiues tjerë, me ç'rast ecuria e kredisë dhe çmimet e aseteve rezultuan të performojnë më së miri në sinjalizimin e akumulimit të rreziqeve për sektorë financiar të shteteve të caktuara (Borio dhe Drehman, 2009; Rüser, 2012). Modelet e ndryshme të sinjalizimit të hershëm gjetën aplikim edhe në sektorin privat i cili përdorte këto sisteme për të monitoruar rrezikun e ndryshimeve të çmimit të aseteve të ndryshme dhe patundshmërive (Dattels et al., 2010). Përkundër kontributit të këtyre metodave në sinjalizimin e rreziqeve për stabilitetin financiar, Dattels et al. (2010) argumentojnë se qasja e tyre është joadekuate për sinjalizimin e krizave për disa arsye: thjeshtojnë problemin duke u fokusuar në një segment të vetëm si dhe japin informacion të limituar për shkak se shpesh fokusohen në indikatorë që vonohen në sinjalizimin e krizave.

Në vitet e fundit, sidomos pas krizës së fundit financiare, është rritur rëndësia e qasjes makro-prudenciale të vlerësimit dhe monitorimit të stabilitetit financiar, e cila po e plotëson rolin e qasjes mikro-prudenciale të mbikëqyrjes. Me këtë, ka ndryshuar edhe qasja e zhvillimit të metodave të vlerësimit të stabilitetit financiar, ku nga metoda të koncentruara në aspekte individuale të sistemit dhe matje të rrezikut të dështimit të institucioneve individuale, po lëvizet

³ Faqja zyrtare e internetit e Fondit Monetar Ndërkombëtar: www.imf.org

drejtë metodave më gjithëpërfshirëse të analizimit dhe vlerësimit të rrezikut të sistemit. Këto metoda përfshijnë vlerësimin e rrezikut të tregjeve financiare, institucioneve financiare dhe infrastrukturës, si dhe vlerësimin e dinamikës së sjelljeve të faktorëve të ndryshëm, rrezikun e ndërtimit gradual të rrezikut nga aspekte të brishta të sektorit, si dhe mekanizmat e ndryshëm transmetues të goditjeve (Gadanecz dhe Jayaram, 2009).

Shumica e analizave për sektorin financiar bazohen në vlerësimin dhe monitorimin e variablave kryesore makroekonomike, të zhvillimeve në sektorë në të cilët sektori financiar ka ekspozim të lartë, dhe vlerësimin e indikatorëve që sinjalizojnë qëndrueshmërinë e vet sektorit ndaj zhvillimeve të mundshme negative të cilët, bazuar në literaturën ekonomike dhe përvojën financiare, pasqyrojnë burimet kryesore të rrezikut dhe brishtësitë e sektorit financiar. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve analiza është e prirur të jetë shumë përshkruese dhe me fokus në të kaluarën, gjë që e vështirëson komunikimin e rrezikut për stabilitetin financiar dhe krahasueshmërinë me periudha paraprake.

Metodat kuantitative të cilat përdoren gjerësisht në vlerësimin e rreziqeve dhe qëndrueshmërisë së sektorit financiar janë ato të bazuara në analizën e ndjeshmërisë ndaj ngjarjeve dhe skenarëve ekstrem negativ në sektorë dhe tregje të ndryshme, dhe efektin e bartjes së rreziqeve të tyre në sektorin bankar (stres testet) dhe anasjelltas. Modelet e vlerësimit të institucioneve me rëndësi sistemike, si dhe modele të parashikimit të variablave të sektori financiar gjithashtu janë bërë pjesë integrale e vlerësimeve për stabilitetin financiar (Worrell, 2004).

Përpjekje të vazhdueshme janë bërë gjithashtu në ndërtimin e masave të përbëra kuantitative për paraqitjen e rrezikut të stabilitetit financiar në një tregues të përgjithshëm. Sipas Gadanecz dhe Jayaram (2009), masat agregate të vlerësimit të stabilitetit financiar janë atraktive për politikëbërësit dhe palët e tjera të interesit për disa arsye: a) i'u mundësojnë atyre monitorimin më të lehtë të shkallës së rrezikut të stabilitetit financiar, b) ofrojnë mundësi për parashikimin dhe vlerësimin e burimeve dhe shkaqeve të stresit financiar, dhe c) mundësojnë komunikimin më të lehtë dhe më efektiv të ndikimit të faktorëve të rrezikut.

Ndër masat më të zakonshme të përbëra kuantitative janë indekset e stabilitetit financiar. Këto indekse në përgjithësi synojnë që të përfshijnë një aspekt më të gjerë të stabilitetit financiar dhe njëkohësisht të pasqyrojnë rrezikun ndaj tij në mënyrë të përmbledhur dhe të matshme. Shembuj më të hershëm të indekseve të sektorit financiar përfshijnë: Indeksën e stresit financiar për Kanadanë nga Illing dhe Liu (2003), i cili përfshinë zhvillimet në sektorin bankar dhe në tregjet e valutave, borxhit dhe kapitalit; Indeksën e stresit financiar për sektorin bankar të Zvicrës nga Hanschel dhe Monnin (2005) që bazohet në të dhëna të pasqyrave financiare të bankave, të tregut ndërbankar si dhe të dhëna të mbikëqyrjes bankare; Indeksën e stabilitetit financiar për Holandën dhe gjashtë vende tjera të OECD-së nga Van den End (2006), i cili përfshinë indikatorë të tregjeve financiare dhe variabla makroekonomike, dhe i krahason ato me kufinj të jostabilitetit; Indeksën e rrezikut bankar për Norvegjinë nga Andersen (2008), që bazohet vetëm në të dhëna të pasqyrave financiare të bankave. Fondi Monetar Ndërkombëtar ka ndërtuar disa indekse të stresit financiar që kombinojnë zhvillimet e sektorit bankar dhe zhvillimet tjera financiare dhe makroekonomike (Dattels, et al., 2011). Banka Qendrore Evropiane gjithashtu ka ndërtuar një indikator të përbërë të stresit sistemik financiar i cili ka gjetur aplikim në eurozonë (Hollo et al., 2012). Tashmë shumica e bankave qendrore aplikojnë ndonjë variacion të indeksit të stabilitetit financiar për vlerësimin dhe komunikimin e rrezikut në sektorin financiar në tërësi apo në sektorin bankar në veçanti. Banka Qendrore e Kosovës

gjithashtu ka zhvilluar 'Indeksin e Stabilitetit të Sektorit Bankar' i cili vlerëson rrezikun e sektorit bankar bazuar në të dhëna të pasqyrave financiare të bankave.⁴

Këto indekse janë mënyrë e dobishme e prezantimit në mënyrë të thjeshtë të rrezikut të përgjithshëm ndaj stabilitetit financiar. Megjithatë, është argumentuar që kompleksiteti dhe aspektet e shumëfishta të rrezikut të stabilitetit financiar është vështirë të përmbledhen në një indikator të vetëm ngase humbet informacioni mbi burimet e rrezikut për stabilitetin financiar. Andaj, Fondi Monetar Ndërkombëtar, për të plotësuar këtë mungesë të metodave të mëhershme, ka zhvilluar modelin e Hartës së Stabilitetit Financiar (FMN, 2007) e cila mundëson analizimin e njëkohshëm të aspekteve të ndryshme të brishtësive dhe rreziqeve ndaj stabilitetit financiar, si dhe ruan karakteristikën e gjithëpërfshirjes dhe paraqitjes së agreguar të rrezikut ndaj stabilitetit financiar. Harta e Stabilitetit Financiar, ndryshe e quajtur edhe diagram i rrezikut të sektorit financiar, paraqet në mënyrë grafike rrjetore kategoritë kryesore të rrezikut dhe brishtësive të stabilitetit financiar, si dhe mundëson paraqitjen e ndryshimit të tyre në disa etapa kohore.

1. Modelet e hartave të stabilitetit dhe aplikimi i tyre

Zhvillimi i Hartës Globale të Stabilitetit Financiar (HGFS) nga FMN dhe përparësitë e saj në paraqitjen dhe komunikimin e brishtësive dhe burimeve të rreziqeve në një rën anë, si dhe rritja e fokusit në vlerësimin e rrezikut të stabilitetit financiar pas krizës globale të vitit 2008 në anën tjetër, i kanë dhënë hov zhvillimit të modeleve të diagrameve rrjetore për vlerësimin e stabilitetit financiar të vendeve të ndryshme.

Harta Globale e Stabilitetit Financiar nga FMN (Dattels et al., 2011)⁵ paraqet në mënyrë grafike gjendjen e stabilitetit financiar përmes diagramit rrjetor gjashtë dimensional. Katër nga dimensionet e diagramit rrjetor prezantojnë kategori të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar (rreziku makroekonomik, rreziku nga tregjet në zhvillim, rreziku kreditor dhe rreziku i financimit dhe likuiditetit), ndërsa dy dimensionet tjera përfaqësojnë kushtet globale të tregjeve financiare dhe prirjen për të ndërmarrë rrezik. Secila nga dimensionet e rrezikut ndërtohet nga komponentë apo nëntregues me peshë të barabartë. Diagrami në formë të rrjetës së merimangës prezanton rrezikun në shkallë rritëse nga qendra drejt skajeve. Sa më larg qendrës që është pozicionuar treguesi, aq më i lartë rreziku. Notat për dimensionet e rrezikut shtrihen nga 0-10 dhe ndërtohen duke i shndërruar vlerat e grupit të nëntreguesve në njëmbëdhjetë kategori të percentilave varësisht prej vlerave të tyre historike. Vendosija e notave të rrezikut komplementohet nga gjykimi i ekspertëve.

Banka Qendrore Evropiane, e motivuar nga HGFS, ka ndërtuar një metodologji të re për vizualizimin e gjendjes së stabilitetit financiar dhe burimet e rrezikut për vendet e saj anëtare, e cila bazohet në metoda ekonometrike të parashikimit të variablave, dhe në grupimin e tyre sipas veçorive të ngjashme. Për dallim nga HGFS, harta e BQE-së (ang: Self-organizing Financial Stability Map) mundëson prezantimin dy dimensional të hapësirës shumë dimensionale të stabilitetit financiar në të cilën mund të veçohen burimet individuale me ndikim në rrezikun sistematik. Ajo gjithashtu mundëson monitorimin e rreziqeve makrofinanciare për vendet e ndryshme duke i pozicionuar ato në ciklin e stabilitetit financiar të hartës të ndarë në katër

⁴ Raporti i Stabilitetit Financiar Nr.9, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

⁵ Versioni i vitit 2011 të HGFS të FMN-së paraqet avancim të modelit bazë të zhvilluar në vitin 2007.

periudha: në periudhën e para krizës, në krizë, pas krizës apo në gjendje të qetë (Sarlin dhe Peltonen, 2011).

Banka të shumta qendrore kanë zhvilluar modelet e tyre të hartave të stabilitetit, duke i'a përshtatur ato specifikave të ekonomive të tyre. Banka e Zelandës së Re (Bedford dhe Bloor, 2009) përdorë metodologji të ngjashme me atë të FMN-së, duke paraqitur pesë dimensione të rrezikut: tri të ndërlidhura me kushtet makroekonomike dhe financiare (ambienti i brendshëm makroekonomik, kushtet e tregjeve financiare dhe ambienti i jashtëm makroekonomik), dhe dy të tjera me shëndetin e brendshëm të sektorit (kapitali dhe profitabiliteti, si dhe likuiditeti dhe financimi). Për dallim nga FMN, Banka e Zelandës së Re standardizon treguesit dhe peshon të dhënat sipas rëndësisë në ndërtimin e kategorive të rrezikut. Banka e Norvegjisë (Dahl et al., 2011) ka ndërtuar një hartë shtatëdimensionale të stabilitetit për sektorin e saj bankar, si sektorin me peshë më të madhe për stabilitetin financiar. HSF e Bankës së Norvegjisë paraqet ndryshimet në brishtësitë dhe në rreziqet e jashtme të sektorit bankar. Brishtësitë e sektorit, që njëherit paraqesin treguesit që vlerësojnë aftësinë e sektorit për përballimin e goditjeve të mundshme, janë paraqitur në tri dimensione: kapitali dhe profitabiliteti, financimi, dhe struktura e sektorit bankar. Rreziqet e jashtme përfshijnë rrezikun nga kushtet makroekonomike, tregu i parasë dhe kredisë, ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Metodologjia e ndërtimit dhe notimit është e ngjashme me atë të HGSF nga FMN. Banka e Shqipërisë (Saqe et al., 2015) gjithashtu ndërton HSF-në duke përfshirë vetëm sektorin bankar. Metodologjia e ndërtimit bazohet në atë të FMN-së, dhe paraqet rrezikun përmes tetë dimensioneve në vijim: Ekonomisë së brendshme, Individëve, Bizneseve, Qeverisë, Mjedisit të jashtëm ekonomik, Kapitalizimit dhe përfitueshmërisë, Likuiditetit dhe financimit, si dhe Strukturës së sektorit Bankar. Banka e Latvisë (Lielkalne dhe Sinenko, 2015) ndërton HSF-në në gjashtë dimensione të rrezikut: rreziku i jashtëm dhe ai i brendshëm makroekonomik, rreziku kreditor nga korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare dhe rreziku i likuiditetit dhe ai i solvencës e profitabilitetit të institucioneve kredidhënëse. Pësia e nëntreguesve është e barabartë, me përjashtim të një nëntreguesi që veçohet me peshë më të lartë.

Karakteristikat e përbashkëta të HSF-ve në të gjitha këto vende janë se paraqesin grafikisht në formë të diagramit rrjetor burimet kryesore të rrezikut për stabilitetin financiar të vendeve të tyre. Notat e rrezikut shtrihen nga 0-10 dhe pozicionimi sa më afër qendrës paraqet rrezik më të ulët. Diagrami përfshinë rrezikun për disa periudha kohore, kryesisht për 2-3 periudha kohore, gjë që mundëson vlerësimin e ecurisë së rrezikut për secilën kategori. Kategoritë e rrezikut janë të prirur të grupohen në faktorë të jashtëm dhe brendshëm makroekonomik, rreziku kreditor nga sektori i korporatave dhe ekonomive familjare, si dhe rreziqet e brendshme të sektorit si ai kreditor, i solvencës dhe i likuiditetit. Sidoqoftë, përzgjedhja e tyre përcaktohet nga veçoritë dalluese të sektorëve financiar të vendeve, si dhe nga disponueshmëria me të dhëna.

Dallimet kryesore në mes të hartave të ndryshme të stabilitetit financiar qëndrojnë në metodologjinë e vlerësimit. FMN, Banka e Norvegjisë dhe ajo e Shqipërisë kryesisht përdorin metodën e percentilave për përcaktimin e kategorive të rrezikut për nëntreguesit. Të dhënat ndahen në 11 kategori të percentilave varësisht prej të dhënave të tyre historike. Kahu i rrezikut përcaktohet varësisht prej natyrës së nëntreguesit: i drejtë (kur rritja e vlerave të nëntreguesit paraqet rritje të rrezikut) apo i zhdrejtë (në rastet kur rritja e vlerave të nëntreguesit paraqet rënie të rrezikut). FMN ndërton kategori fikse të percentilave të cilat nuk ndryshojnë me shtimin e observimeve të reja. Mirëpo, kjo metodë është plotësuar nga Banka e Norvegjisë me shtimin e observimeve të reja, ngase në rast të mos përfshirjes së tyre mund të humbet informacion i

rëndësishëm kur observimet e fundit dallojnë dukshëm nga vlerat historike. Në rastet kur metoda e percentilave nuk përshtatet për pasqyrimin e rrezikut, p.sh. të dhënat nuk kanë shtrirje normale apo seritë kohore janë të shkurtra, Banka e Norvegjisë përdorë metode alternative të notimit të bazuar në standardizimin e indikatorëve dhe përcaktimin e kufijve të rrezikut sipas gjykimit të ekspertëve. Banka e Zelandës së Re standardizon treguesit duke pjesëtuar diferencën e vlerës së treguesit nga mesatarja e serisë kohore me standard devijimin e vlerës së serisë. Gjykimi është përdorur shumë shpesh në përcaktimin e mesatares dhe devijimit standard kur është vlerësuar se mostra e të dhënave nuk reflekton drejtë shpërndarjen e të dhënave. Gjykimi gjithashtu është përdorur në përcaktimin e peshës së nëntreguesve për llogaritjen e vlerës së gjithsej treguesit apo kategorisë përkatëse. Banka e Latvisë kombinon tri metoda për përcaktimin e notave, varësisht prej shpërndarjes së të dhënave të nëntreguesve dhe interpretimit të tyre ekonomik. Metoda e ashtuquajtur standarde e ndarjes së të dhënave në 11 intervale të barabarta të percentilave, në rastet kur të dhënat i përafrohen shtrirjes normale. Çdo interval i percentilave korrespondon me një note rreziku nga 0-10, me ç'rast intervali i mesit me notën 5 përmbanë medianen e serisë kohore. Kur të dhënat janë asimetrrike, përdoret një metodë alternative bazuar në medianën e serisë kohore. Intervali i mesit përmbanë medianën, ndërsa intervalet tjera ndahen në intervale të barabarta. Metoda e tretë është vlerësim i ekspertëve për reprezentimin sa më adekuat të rrezikut.

Pavarësisht përparësive të metodave agregate dhe të konsoliduara të rreziqeve të sektorit financiar në vlerësimin dhe komunikimin e rreziqeve ndaj stabilitetit financiar, asnjë metodë kuantitative, përfshirë këtu hartën e stabilitetit financiar, nuk duhet të konsiderohet e mjaftueshme si e vetme për vlerësimin e rrezikut të stabilitetit financiar pa u komplementuar nga metoda tjera kuantitative dhe vlerësimi kualitativ që pasqyron gjykimin e ekspertëve të fushës (Gadanecz dhe Jayaram, 2009). Harta e stabilitetit financiar duhet të shihet vetëm si një ndër mjetet që mundëson komunikimin më të thjeshtë dhe më të qartë të rreziqeve ndaj stabilitetit, dhe që që shërben si platformë për nxitjen e diskutimeve rreth burimeve të këtyre rreziqeve (Dattels et al., 2011).

III. Metodologjia e ndërtimit të HSF-së për Kosovën

Harta e Stabilitetit Financiar të Kosovës synon të shërbej si vegël analitike për vlerësimin dhe komunikimin e ndryshimeve të brishtësive dhe rreziqeve ndaj sektorit bankar në Kosovë, si dhe paraqitjen e tyre në formë grafike përmes diagramit rrjetor. Marrë parasysh peshën e lartë të sektorit bankar në gjithsej sektorin financiar në Kosovë, HSF është dizajnuar vetëm për sektorin bankar.


Metodologjia e hartës është bazuar kryesisht në metodologjinë e përdorur nga Banka e Shqipërisë (Saqe et al., 2015) dhe nga Banka e Norvegjisë (Dahl et al., 2011), ku faktorët me ndikim në sektorin bankar ndahen në dy kategori: brishtësitë e sektorit bankar si dhe burimet e jashtme të rrezikut të sektorit bankar (figura 1). Për shkak të ngjashmërisë së strukturës së ekonomisë së Kosovës dhe sektorit financiar me atë të Shqipërisë, përzgjedhja e kategorive dhe nënkategorive përkatëse është

bazuar në modelin e Bankës së Shqipërisë (Saqe et al., 2015), duke e përshtatur atë ndaj rrethanave në Kosovë. Harta përfshinë treguesit që masin rrezikun brenda sektorit bankar (të paraqitura në anën e majtë të grafikut në figurën 1), përkeqësimi i të cilëve ndikon në dobësimin e aftësisë së bankave për të përballuar goditjet e mundshme. Treguesit tjerë (të paraqitur në këndet e mesit si dhe ato në anën e djathtë të diagramit rrjetor në figurën 1) paraqesin faktorët e jashtëm, apo burimet e jashtme të rrezikut për sektorin bankar siç janë ambienti makroekonomik i brendshëm dhe i jashtëm, sektori i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, si dhe qeveria.

FMN, në bazë të përvojës së tyre praktike, sugjeron që niveli optimal i nëntreguesve për përfaqësimin sa më adekuat të treguesit pa rrezikuar mbivendosjen e informacionit apo nën/mbi vlerësimin e nëntreguesëve të caktuar, është 4 deri në 8. Andaj, secili tregues në HSF të Kosovës është ndërtuar nga një numër i nëntreguesëve brenda këtij intervali.⁶ Informacioni që japin disa nëntregues është përfshirë njëkohësisht në disa kategori të rrezikut. Megjithatë, sugjerohet që përfshirja e informacioneve të caktuara në disa kategori është e pashmangshme ngase nëntreguesit e njëjte përdoren në vlerësimin e rrezikut në mënyra të ndryshme dhe rëndësia e informacionit që japin për vlerësimin e kategorisë përkatëse arsyeton përfshirjen e tyre (Dattels et al., 2011).

Për ndërtimin e shkallëve të rrezikut është përdorur metoda standarde e vlerësimit apo metoda me percentile, si dhe metoda alternative për rastet kur metoda standarde nuk ka qenë e përshtatshme me natyrën e të dhënave.⁷ Janë përdorur disa variacione të metodës alternative, disa me bazë matematikore (metoda e mesatares dhe devijimit standard), ndërsa të tjerat janë

Figura 1. Dimensionet e rrezikut të hartës së stabilitetit financiar në Kosovë



Burimi: BQK (2016)

⁶ Kriteri i përfshirjes së 4-8 nëntreguesve nuk plotësohet për të gjitha periudhat kohore (që është relevante në analizimin e performancës së nëntreguesve në sinjalizimin e krizave), ngase të dhënat për disa prej nëntreguesve nuk datojnë në periudhat e hershme të funksionimit të sektorit. Sidoqoftë, nga viti 2010, të dhënat për pothuajse të gjithë nëntreguesit janë në dispozicion dhe treguesit kanë informacion të mjaftueshëm.

⁷ Shpërndarja statistikore e të dhënave si dhe interpretimi i tyre ekonomik, ngjashëm me studimin e Bankës së Norvegjisë dhe atë të Latvisë, ka diktuar metodën e cila është përdorur për vlerësimin/vënien e notave të rrezikut të treguesve.

adaptuar në bazë të gjykimit profesional me qëllim të reflektimit më adekuat të rrezikut. Nëntreguesit marrin vlera prej 0 deri në 10, ku vlerat më të ulëta paraqesin rrezik më të ulët dhe anasjelltas. Për dhënien e notave të rrezikut të nëntreguesve, është vlerësuar kahu i lëvizjes së vlerës së tyre në raport me notat e rrezikut. Në rastet kur rritja e vlerës së nëntreguesit nënkupton rritje të rrezikut, kahu i notimit të nëntreguesit është definuar si ‘i drejtë’, ndërsa në të kundërtën notimi është konsideruar të ketë kahje të ‘zhdrejtë’. Pas notimit të secilit nga nëntreguesit, llogaritet nota e përgjithshme e treguesit apo kategorisë së rrezikut, si mesatare e thjeshtë e notave të nëntreguesve përbërës. Në shumicën e studimeve të HSF-ve preferohet mesatarja e thjeshtë krahas asaj të peshuar ngase përcaktimi i peshave të rëndësisë së nëntreguesve për kategorinë përkatëse të rrezikut sugjerohet të shtojë subjektivitetin e hartës si dhe komplikon krahasueshmërinë meqë peshat ndryshojnë në kohë.

Për ndërtimin e nëntreguesve janë marrë për bazë të dhënat kuartale, duke filluar nga viti 2000. Sidoqoftë, për shumicën e nëntreguesve të dhënat datojnë nga periudha më të vonshme, ndaj dhe janë shfrytëzuar të dhënat më të hershme që kanë qene në dispozicion.⁸ Të dhënat të cilat nuk kanë qenë të disponueshme në baza kuartale kanë pësuar transformime: janë shndërruar në të dhëna kuartale përmes metodës së interpolimit të thjeshtë, metodës ‘cubic spline’, apo përmes nxjerrjes së mesatares historike të peshës së pjesëmarrjes së kuartaleve përkatës në gjithsej shumë vjetore të nëntreguesëve. Ndërtimi i hartës në ‘kohë reale’ rezulton problematik për shkak se shumë të dhëna që përdoren në ndërtimin e saj marrin disa muaj që të publikohen. Andaj, për ndërtimin e hartës për periudhën e fundit, qershor 2016, janë shfrytëzuar të dhënat e fundit në dispozicion. Metoda e përditësimit të hartës bazohet në atë të Bankës së Norvegjisë, sipas së cilës intervalet e percentilave rivlerësohen për të përfshirë observimin e fundit. Ndërsa, performanca e nëntreguesve në kohë është vlerësuar duke u bazuar në intervalet fikse të percentilave të ndërtuar me përfshirjen e komplet serisë kohore të nëntreguesve.

Nëntreguesit do të jenë subjekt i përmirësimeve gjatë kohës, me ç ‘rast do të monitorohet dhe testohet besueshmëria dhe kontributi i tyre në pasqyrimin e rrezikut. Korrigjime do të bëhen gjithashtu në aspektin e zvogëlimit të problemit të mbivendosjes, si dhe në kualitetin e të dhënave për të minimizuar kufizimet e tyre (përmirësimin e serive kohore, rregullimin e sezonalitetit, zhvendosjen e trendit që nuk ndërlihet me stabilitetin financiar).

Interpretimi adekuat i hartës është i rëndësisë së lartë. Duhet theksuar se për shkak se nëntreguesit vlerësohen krahas ecurisë së tyre historike, nota 5 nënkupton medianën e serisë kohore dhe jo rrezik ‘normal’ të nëntreguesit.⁹ Rrjedhimisht, HSF nuk vlerëson nivelin absolut të rrezikut të Stabilitetit Financiar në një periudhë kohore, por ndryshimin e tij në raport me historikun e tij, ndaj dhe HSF duhet të shihet si vegël për vlerësimin e ndryshimit të rrezikut në raport me periudhat paraprake (p.sh. kuartalet apo vitet paraprake). Gjithashtu, vlerësimi i notave të rrezikut në raport me ecurinë historike bënë që rreziku i treguesve të mos jetë i krahasueshëm mes vete ngase një notë rreziku i një treguesi nuk përfaqëson nivel të njëjtë rreziku me treguesin tjetër me notë të njëjtë, i cili mund të ketë pikën ekuilibruese afatgjate në një shkallë më të lartë të rrezikut.

⁸ Në Shtojcën 1 mund të shihen detajet e përshkrimit të Treguesve, burimit të dhënave dhe metodologjisë së ndërtimit të tyre.

⁹ Është e rëndësishme që seritë kohore të jenë sa më të gjata dhe të përfshijnë disa cikle ekonomike, në mënyrë që mediana të jetë më reprezentative.

IV. Ndërtimi i treguesve dhe nëntreguesve përkatës

Harta e stabilitetit financiar të Kosovës është ndërtuar nga tetë tregues kryesorë, të cilët reflektojnë sektorët kryesorë prej nga mund të burojnë rreziqet për sektorin bankar në Kosovë. Në përzgjedhjen e tyre dhe të nëntreguesve përkatës janë respektuar kriteret kryesore që sugjerohen nga literatura ekzistuese, dhe të cilat janë elaboruar në seksionin e metodologjisë. Marrë parasysh historikun relativisht të shkurtër të sektorit bankar të Kosovës si dhe kufizimet në të dhëna historike për sektorët e tjerë të ekonomisë, disa nga nëntreguesit kanë seri të shkurtra kohore dhe mund të mos reflektojnë disa periudha të krizës apo stresit financiar ashtu siç rekomandon literatura. Megjithatë sektori bankar i Kosovës nuk është ballafaquar direkt me krizë financiare apo periudhë të stresit financiar¹⁰, krizat ndërkombëtare si kriza financiare e vitit 2007-2008 dhe ajo e borxhit që filloi në vitin 2009, kanë pasur ndikim indirekt në tregues të caktuar ekonomik dhe financiarë, prandaj dhe merren parasysh në interpretimin e trendit të nëntreguesve.

1. Ekonomia e jashtme

Zhvillimet në ekonominë e jashtme paraqesin faktorë të rëndësishëm që mund të ndikojnë në ekonominë e brendshme dhe në stabilitetin financiar të Kosovës. Disa nga kanalet përmes të cilave problemet mund të barten në ekonominë e brendshme janë ai i rënies së remitencave, investimeve të huaja si dhe rritjes së deficitit tregtar. Sektori financiar do të ndikohej përmes rënies së aftësisë për shlyerjen e kredive si dhe tërheqjen e mundshme të investimeve nga bankat amë. Burim tjetër rreziku mund të jetë rreziku reputacional nga bankat amë që ndikon në perceptimin mbi filialet ose degët e tyre në Kosovë. Megjithatë sektori bankar i Kosovës ka rezultuar mjaft mirë i mbrojtur nga goditjet në ekonominë e jashtme gjatë krizave të fundit, burimet e rrezikut ekzistojnë dhe është e rëndësishme të monitorohen në vazhdimësi. Treguesi i ekonomisë së jashtme është ndarë në pesë nëntreguesit në vijim:

1.1. Norma e rritjes reale të Bruto Produktit Vendor të partnerëve kryesorë tregtarë

Rritja ekonomike e partnerëve kryesorë tregtarë ka ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike në Kosovë, gjë e cila ndikon në aktivitetin dhe performancën e agjentëve ekonomik dhe aftësinë e tyre për shlyerjen e kredive. Ky nëntregues është ndërtuar si mesatare e ponderuar e rritjes së BPV-së reale të tetë partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës¹¹, me ç'rast si faktor peshues është marrë pjesëmarrja në gjithsej eksportet e Kosovës e eksporteve që Kosova ka në secilin prej vendeve partnere. Rritja e nëntreguesit konsiderohet të sinjalizoj rritje të kërkesës për eksporte në periudhën vijuese, andaj konsiderohet që nëntreguesi të ketë natyrë parashikuese. Notimi për këtë nëntregues është i zhdrejtë, ngase rritja e BPV-së së partnerëve tregtarë sugjeron për rrezik më të ulët për ekonominë dhe stabilitetin financiar të vendit.

1.2. Norma e ponderuar e papunësisë e vendeve me numër më të madh të diasporës kosovare

Ky nëntregues është marrë si tregues i përafërt i kushteve të tregut të punës në vendet me numrin më të madh të diasporës Kosovare. Supozimi për këtë nëntregues është që sa më e lartë

¹⁰ Periudha të krizës apo stresit financiar konsiderohen periudhat në të cilat problemet me likuiditet apo kapitalizim rezultojnë në ndërmarrje të masave të qeverisë për tejkalimin e problemeve.

¹¹ Tetë partnerët kryesorë tregtarë, të cilët përbëjnë rreth 67% të gjithsej eksporteve të Kosovës, janë: Gjermania, Italia, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Turqia dhe India.

të jetë norma e papunësisë në këto vende, dërgesat e emigrantëve do të jenë më të ulëta¹². ndaj dhe aftësia paguese e qytetarëve më e ulët. Nëntreguesi është ndërtuar si mesatare e ponderuar e normës së papunësisë së katër¹³ vendeve prej nga vjen pjesa më e madhe e dërgesave të emigrantëve kosovarë. Notimi për këtë nëntregues është i drejtë, ngase rritja e papunësisë në shtetet me numër më të madh të dërgesave të emigrantëve ndikon në rënien e gjithsej remitencave dhe rritjen e rrezikut për sektorin financiar.

1.3. Çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare

Ndryshimet në çmimet ndërkombëtare të naftës ndikojnë në mënyrë direkte në ekonominë e Kosovës e cila është importuese e naftës, por edhe në mënyrë indirekte përmes ndikimit në çmimet e produkteve tjera të importuara. Supozimi për këtë nëntregues është që rënia e çmimeve të naftës ndikon në rënien e çmimeve të produkteve të importuara si dhe në rënien e kostos së prodhimit, që rrjedhimisht reflektohet pozitivisht në buxhetin e agjentëve ekonomik. Nëntreguesi është ndërtuar si ndryshimi vjetor i normës mesatare tremujore të çmimeve mujore të raportuara në databazën e Çmimeve të Mallrave të Bankës Botërore. Notimi për këtë nëntregues është i drejtë: rritja e çmimeve nënkupton rritje të rrezikut për stabilitetin financiar.

1.4. Indeksi kryesor i përbërë i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD Composite Leading Indicators: OECD Europe)

Indeksi i OECD-së është tregues i njohur ndërkombëtarisht për sinjalizimin e pikave të kthimit në ciklin e biznesit, duke matur devijimin e aktivitetit ekonomik nga niveli i tij potencial afatgjatë. Indeksi ndërtohet nga bashkimi i disa nënkategorive që synojnë të përfaqësojnë sa më mirë sektorët kryesorë të ekonomisë, siç janë: çmimet e mallrave, vëzhgimet dhe opinionet mbi aktivitetin afarist dhe ekonomik, të dhëna për sektorin e punësimit dhe të dhëna tjera monetare dhe financiare. Në këtë rast është konsideruar indeksi i OECD-së për Evropën, si përfrues i parashikimit të aktivitetit ekonomik në Evropë. Nëntreguesi është ndërtuar si mesatare tremujore e vlerave mujore të indeksit.¹⁴ Notimi për këtë nëntregues është i zhdrejtë: rënia e vlerave të treguesit nënkupton ngadalësim të aktivitetit ekonomik dhe rrezik të rritur për ekonominë e Kosovës dhe sektorin financiar.

1.5. Norma mesatare e LIBOR dhe EURIBOR 3-mujorë

Kosto e fondeve në tregjet ndërkombëtare është zhvillim me rëndësi që mund të ketë ndikim në sektorin financiar vendor në mënyrë direkte, përmes bankave amë si dhe rritjes së kostos së huamarrjes jashtë vendit, por edhe në mënyrë indirekte përmes ndikimit në aktivitetin e agjentëve ekonomikë të vendeve partnere duke ndikuar në kërkesën për fonde dhe në investime. Për shkak të ndërveprimit të Kosovës kryesisht me tregun evropian, si matëse e kostos së fondeve në këtë treg është konsideruar mesatarja 3 mujore e normave bazë referente, LIBOR dhe EURIBOR në euro me maturitet 3 mujorë. Notimi është i drejtë: kosto e lartë e fondeve, rrezik më i lartë për stabilitetin financiar.

¹² Në një studim të papublikuar të Fondit Monetar Ndërkombëtar në vitin 2013, ka rezultuar që ekonomia e Kosovës është në masë të madhe e varur nga diaspora kosovare në Gjermani dhe Zvicër, dhe që rritja në Kosovë ndikohet në masë të rëndësishme nga rritja ekonomike në këto vende.

¹³ Mesatarisht 70% e gjithsej remitencave në Kosovë vijnë nga vendet si Gjermania, Zvicra, Italia dhe Austria.

¹⁴ Notimi është bërë sipas një metode alternative të ndarjes së intervaleve të barabarta ndërmjet vlerave të indeksit, ngjashëm me punimin e Bankës së Shqipërisë (Saqe et al., 2015) dhe atë të Bankës së Norvegjisë (Dahl et al., 2011). Arsyeshmëria për këtë metodë është se shpërndarja e të dhënave nuk është normale (fat tail distribution) dhe metoda standarde e percentilave rezulton në nota rreziku të ndryshme për ndryshim shumë të vogël të vlerës së indeksit.

2. Ekonomia e brendshme

Kushtet makroekonomike në vend kanë ndikim në të hyrat dhe shpenzimet e agjentëve ekonomikë, prandaj dhe ndikojnë në kapacitetin e tyre për të bërë shlyerjen e borxheve ekzistuese. Rritja ekonomike dhe prospektet për ecurinë e saj gjithashtu kanë ndikim në mënyrën se si perceptohet rreziku nga pjesëmarrësit në treg, prandaj dhe ka ndikim të madh në sjelljet e vet agjentëve të sektorit financiar. Për të vlerësuar sa më mirë rrezikun nga zhvillimet makroekonomike, Dahl et al. (2011) sugjerojnë që nëntreguesit e përzgjedhur të reflektojnë si ndryshimet afatshkurtëra ciklike në ekonomi, ashtu edhe ato me aspekt më afatgjatë strukturor. Andaj, marrë parasysh këtë sugjerim, nëntreguesit e përzgjedhur përfshijnë:

2.1. Hendeku i prodhimit

Hendeku i prodhimit paraqet BPV-në aktuale në krahasim me nivelin potencial të saj.¹⁵ Nëntreguesi i hendekut të prodhimit matë diferencën mes prodhimit aktual dhe atij potencial në rast të shfrytëzimit të plotë të kapaciteteve prodhuese. Hendeku pozitiv asociohet me kërkesë të lartë në ekonomi dhe shfrytëzim të lartë të kapaciteteve të ekonomisë, ndërsa hendeku negativ sugjeron për kërkesë të ulët dhe mos shfrytëzim të plotë të kapaciteteve të ekonomisë. Për dallim nga norma e rritjes ekonomike, hendeku vlerëson aktivitetin ekonomik në periudhën aktuale duke marrë parasysh edhe zhvillimet në të kaluarën, prandaj ashtu si në punimin e Saqe et al. (2015), është favorizuar për përdorim në këtë punim. Notimi për këtë nëntregues është i zhdrejtë: një normë më e lartë nënkupton shfrytëzim më të madh të kapaciteteve të ekonomisë apo aktivitet më të lartë ekonomik dhe, rrjedhimisht, rrezik më të ulët për sektorin financiar.

2.2. Madhësia e borxhit të jashtëm

Raporti i borxhit të jashtëm ndaj Bruto Produktit Vendor paraqet raportin e ngarkesës me borxh që shteti i Kosovës ka ndaj jorezidentëve. Nëntreguesi ka karakter afatgjatë strukturor që sinjalizon akumulimin e borxhit të ekonomisë. Borxhi i lartë konsiderohet i dëmshëm për ekonominë e një vendi, andaj ekonomitë duhet të jenë të kujdesshme që të mos akumulojnë borxh mbi nivelin e qëndrueshëm për fundamentalet e ekonomisë.¹⁶ Borxhi i lartë rritë varësinë e vendit ndaj burimeve të jashtme të financimit dhe ndryshimit të kushteve në tregjet globale, gjë që rritë rrezikun e financimit të ekonomisë në përgjithësi, por edhe sektorit financiar në veçanti pavarësisht a është i ekspozuar direkt apo indirekt ndaj këtij borxhi. Gjithashtu, borxhi i lartë i vendit rritë perceptimin për rrezikun e vendit ndaj dhe ndikon në koston e financimit nga jashtë të të gjithë sektorëve huamarrëse, përfshirë sektorin privat dhe atë financiar. Nëntreguesi është ndërtuar si raport i shumës së borxhit të jashtëm ndaj BPV-së vjetore. Notimi i këtij nëntreguesi është i drejtë: rritja e raportit të borxhit ndaj BPV-së paraqet rritje të rrezikut për ekonominë dhe stabilitetin financiar.¹⁷

2.3. Bilanci i llogarisë rrjedhëse

Bilanci i llogarisë rrjedhëse tregon për bilancin tregtar - diferencën ndërmjet vlerës së eksporteve dhe importeve të mirave dhe shërbimeve të një vendi, dhe në këtë aspekt konsiderohet si matës i

¹⁵ Logaritja e hendekut të prodhimit është bërë përmes metodës së filterit Hodrick-Prescott.

¹⁶ Sipas Bankës Botërore dhe FMN-së, nivel i qëndrueshëm i borxhit të jashtëm sugjerohet të jetë "niveli në të cilin vendi mund të përmbushë plotësisht detyrimet aktuale dhe të ardhshme për shlyerjen e borxhit të jashtëm, pa pasur nevojë për riaranzhim të planit të kthimit apo akumulimin e borxheve të pakthyera, si dhe pa penguar rritjen ekonomike".

¹⁷ Intervali i rrezikut është kufizuar në notat 3-6 ngase në rast të intervalit të plotë, shtrirja e koncentruar e të dhënave jep rrezik shumë të lartë apo të ulët për observimet e skajshme të cilat dallojnë pak nga mesatarja e serisë.

konkurrentshmërisë së vendit. Mirëpo bilanci i llogarisë rrjedhëse përfshinë gjithashtu edhe pozicionin neto nga kompensimi i punëtorëve, të hyrat nga interesi dhe dividendat, si dhe transferet nga jashtë, prandaj ai konsiderohet gjithashtu si tregues i raportit të kursimeve dhe investimeve të shtetit. Gjykimi nëse bilanci pozitiv apo negativ i llogarisë rrjedhëse paraqet rrezik për ekonominë e shtetit varet nga burimet të cilat e ndikojnë deficitin apo suficitin, pra nga struktura e ekonomisë dhe e bilancit të llogarisë rrjedhëse. Kur bilanci negativ i llogarisë rrjedhëse buron nga deficitin i vazhdueshëm tregtar për produkte konsumuese (dhe jo produkte të lëndëve të para që sugjerojnë për kapacitet më të lartë prodhues të ekonomisë në të ardhmen), ai sinjalizon për probleme të konkurrentshmërisë së vendit dhe ekonomi të bazuar në konsum. Bilanci negativ, sidoqoftë, mund të sugjerojë për ekonomi në rritje në rastin kur niveli investimeve të jashtme është i lartë. Në rastin e Kosovës, bilanci negativ në masë të madhe rrjedhë nga deficitin i lartë tregtar për produkte konsumuese, i cili pjesërisht mbulohet nga të hyrat nga transferet për ekonomitë familjare (remitencat). Ky nëntregues është ndërtuar si raport i bilancit të llogarisë rrjedhëse ndaj BPV-së vjetore. Notimi për nëntreguesin është i zhdrejtë: një raport i lartë negativ i llogarisë rrjedhëse ndaj BPV-së paraqet konkurrentshmëri të ulët dhe varësi të lartë të financimit të konsumit nga jashtë, që tregon për rrezik të shtuar për stabilitetin financiar.

2.4. Lulahshmëria e kursit të këmbimit

Ndryshimet në kursin e këmbimit të euros në raport me valutat tjera mund të paraqesin rrezik direkt për stabilitetin e sektorit financiar duke ndikuar pozicionet e hapura neto të bankave në valutë, por edhe në mënyrë indirekte përmes ndikimit të nivelit të të ardhurave të sektorit të tregtisë dhe të qytetarëve të cilët financohen nga jashtë (remitencat në valutë të huaj). Për matjen e ndryshimeve të kursit të këmbimit të euros në raport me valutat tjera është shfrytëzuar indeksi i Normës Reale Efektive të Këmbimit – NREK të publikuar nga BQK-ja. Nëntreguesi është ndërtuar si ndryshim vjetor i mesatares tremujore të indeksit. Efekti specifik i ndryshimit të kursit të këmbimit në sektorin bankar si dhe në ekonomi varet nga ekspozimi neto i hapur në secilën valutë. Sidoqoftë, këtu është bërë supozimi i përgjithshëm që vlerësimi i euros paraqet rritje të aftësisë paguese, dhe anasjelltas. Prandaj notimi është i zhdrejtë: Rritja e vlerave të nëntreguesit paraqet rënie të rrezikut.

2.5. Indeksi i çmimeve të konsumit – Inflacioni

Ndryshimet në normën e inflacionit paraqesin pengesa në planifikimin dhe alokimin efektiv të resurseve nga sektori financiar dhe agjentët ekonomik. Norma e interesit të bankave është e lidhur ngushtë me normën e inflacionit, ndaj ndryshimet në normën e inflacionit paraqesin ndryshim në koston e fondeve për bankat. Gjithashtu, inflacioni ndikon aftësinë paguese të agjentëve ekonomik në rastet kur të hyrat janë fikse. Nëntreguesi është ndërtuar si ndryshim vjetor i mesatares tremujore të indeksit të çmimeve të konsumit, ku vit bazë është marrë viti 2015 bazuar në publikimin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Notimi për nëntreguesin është i drejtë: rritja e inflacionit ndikon në rënie të aftësisë paguese dhe rritje të pasigurisë së agjentëve ekonomik dhe bankave, andaj dhe paraqet rritje të rrezikut për stabilitetin financiar.

2.6. Kualiteti i institucioneve gjyqësore

Pavarësia dhe efikasiteti i institucioneve gjyqësore ka ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e sektorit financiar. Sa më i pavarur dhe i zhvilluar sektori gjyqësor, aq më efikase puna e tij në realizimin e kontratave të cilat kanë rëndësi të madhe për bankat në përcaktimin e rrezikut

kreditor. Për vlerësimin e kualitetit të institucioneve gjyqësore është marrë indeksi i Freedom House për Kornizën Ligjore dhe pavarësinë e gjyqësorit.¹⁸ Notimi është i drejtë: sa më e lartë nota, aq më i ulët kualiteti i institucioneve gjyqësore dhe më i lartë rreziku për stabilitetin financiar.

3. Ekonomitë familjare

Gjendja e ekonomive familjare është indikator i rëndësishëm për vlerësimin e stabilitetit financiar në Kosovë ngase ekonomitë familjare janë sektori i dytë, pas ndërmarrjeve, më i kredituar nga sektori bankar. Konsumi i ekonomive familjare gjithashtu ka ndikim indirekt në sektorin bankar përmes ndikimit në kërkesën agregate, e cila ndikon në qarkullimin dhe të hyrat e ndërmarrjeve. Andaj, vlerësimi i gjendjes ekonomike të ekonomive familjare në aspektin e ngarkesës së tyre me borxh, aftësisë për shlyerjen e detyrimeve dhe gatishmërisë për konsum është i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut kreditor. Në rastin e Kosovës, informatat për këtë sektor janë të mangëta (mungojnë të dhënat për të hyrat e ekonomive familjare si dhe për çmimin e patundshmërive). Sidoqoftë, janë ndërtuar pesë nëntreguesit në vijim të cilët synojnë të përafrojnë sa më mirë aspektet e ndryshme të gjendjes së ekonomive familjare:

3.1. Huamarrja e ekonomive familjare

Ky nëntregues paraqet kreditimin e sektorit të ekonomive familjare në krahasim me potencialin e tij. Ai ndërtohet si diferencë e raportit aktual dhe atij potencial të kredive për ekonomitë familjare ndaj BPV-së vjetore.¹⁹ Një normë e lartë pozitive e këtij raporti mund të sugjerojë akumulim të rrezikut kreditor nën supozimin se rritja e kreditimit është bërë mbi bazën e kreditimit joprudent. Sidoqoftë, raporti i kreditimit të ekonomive familjare ndaj BPV-së në Kosovë qëndron në nivel relativisht të ulët²⁰, dhe ka hapësirë për rritje të mëtejme të këtij raporti duke pasur parasysh mesataren e këtij raporti në vendet e tjera. Andaj, në këtë studim, fokusi është në efektin afatshkurtër të nëntreguesit, me ç'rast hendeku pozitiv nënkupton rritje të financimit për ekonomitë familjare dhe zhvillim të mëtejme të sektorit financiar. Rrjedhimisht, notimi për nëntreguesin është i zhdrejtë: normë e lartë pozitive nënkupton rrezik më të ulët për stabilitetin financiar.

3.2. Cilësia e portofolit kreditor të ekonomive familjare

Cilësia e portofolit kreditor është ndër indikatorët që i kushtohet më së shumti vëmendje në vlerësimin e rrezikut kreditor të sektorit bankar. Përkeqësimi i cilësisë së kredive të ekonomive familjare reflekton kapacitet më të ulët të ekonomive familjare për kthimin e kredisë, gjë e cila ndikon direkt profitabilitetin dhe bilancin e gjendjes të sektorit bankar, si dhe në aftësinë e tij për të rritur kreditimin. Nëntreguesi ndërtohet si raport i kredive joperformuese të ekonomive familjare ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare. Notimi është i drejtë: një normë më e lartë e këtij nëntreguesi paraqet rrezik më të lartë për stabilitetin financiar nga ekonomitë familjare.²¹

¹⁸ Indeksi i Freedom House merr vlerat prej 1-7, me ç'rast nota më e vogël paraqet zhvillim më të mirë dhe anasjelltas. Notimi për qëllime të HSF-së është bërë përmes transformimit të indeksit në nota rreziku nga 0 deri në 10.

¹⁹ Logaritja e hendekut të raportit të kreditimit të ekonomive familjare ndaj BPV-së vjetore është bërë përmes filterit Hodrick-Prescott.

²⁰ Sipas të dhënave nga Banka për Rregullime Ndërkombëtare (ang: Bank for International Settlements) dhe GlobalEconomy.com, mesatarja e raportit të kredive të ekonomive familjare ndaj BPV-së për vendet e Europës në vitin 2014 ishte 65.45%, me normën më të ulët 19.8% dhe normën më të lartë prej 126.5%. Në Kosovë, raporti i kredive të ekonomive familjare ndaj BPV-së në vitin 2014 qëndroi në 11.2%, ndërsa në TM2 të vitit 2016 ishte 12.5%.

²¹ Intervali i rrezikut është kufizuar në notat 4-6 për shkak të serisë së shkurtër kohore dhe gjykimit profesional për përfaqësim më adekuat të rrezikut.

3.3. Norma e papunësisë

Norma e papunësisë është tregues i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik të vendit si dhe faktor i rëndësishëm në shpjegimin e gjendjes financiare të ekonomive familjare. Ndryshimi në normën e papunësisë mund të informojë mbi kërkesën e ekonomive familjare, kapacitetin e tyre për shlyerje të borxheve si dhe aftësinë për marrje të kredive të reja. Notimi për nëntreguesin është i drejtë: një normë më e lartë e papunësisë nënkupton rrezik më të lartë për stabilitetin financiar.²²

3.4. Dërgesat e emigrantëve

Dërgesat e emigrantëve janë burim i rëndësishëm i të ardhurave në Kosovë. Në këtë rast, ky nëntregues është marrë si një përafres i gjendjes financiare të ekonomive familjare me supozimin se remitencat rrisin buxhetin e ekonomive familjare, ndaj dhe ndikojnë kërkesën në vend dhe kontribuojnë në shtimin e kapacitetit të ekonomive familjare për kthimin e borxheve ekzistuese dhe marrjen e kredive të reja. Nëntreguesi është ndërtuar si ndryshim vjetor i shumës tremujore të dërgesave. Notimi është i zhdrejtë: një normë më e lartë e rritjes paraqet rrezik më të ulët për stabilitetin financiar.

3.5. Përballueshmëria e pagesave të rregullta

Nëntreguesi i përballueshmërisë së pagesave paraqet aftësinë e ekonomive familjare që të paguajnë në kohë pagesat siç janë qiraja, kreditë, tatimet, shpenzimet komunale, faturat, mirëmbajtjet e rregullta, etj. Vonesa apo pamundësia e pagesave të tilla sinjalizon mbingarkesë me borxh të ekonomive familjare, gjë e cila paraqet rrezik për stabilitetin financiar. Konkretisht, ky nëntregues²³ paraqet numrin e ekonomive familjare të cilat dy herë apo më shumë kanë hasur pengesa në pagesën e shpenzimeve të lartcekura. Notimi për nëntreguesin është i drejtë: rritja e vlerave të raportit sugjeron për rritje të ngarkesës me borxh dhe, rrjedhimisht, rritje të rrezikut për stabilitetin financiar.²⁴

4. Ndërmarrjet

Kreditë për ndërmarrjet (korporatat jo-financiare) përbëjnë rreth 65 përqind të gjithë kredive të sektorit bankar, andaj vlerësimi i shëndetit dhe zhvillimeve të sektorit të ndërmarrjeve është aspekt kyç i vlerësimit të rrezikut të stabilitetit financiar. Të dhënat për sektorin e ndërmarrjeve janë të mangëta, ndaj dhe vlerësimi i rrezikut të sektorit është më i vështirë. Sidoqoftë, ashtu si në rastin e ekonomive familjare, edhe për ndërmarrjet janë ndërtuar pesë nëntreguesit në vijim të cilët synojnë të përafrojnë sa më mirë aspektet e ndryshme të performancës së sektorit të ndërmarrjeve:

4.1. Huamarrja e ndërmarrjeve

Ky nëntregues paraqet kreditimin aktual të sektorit të ndërmarrjeve në krahasim me potencialin e tij. Ngjashëm me huamarrjen e ekonomive familjare, nëntreguesi ndërtohet si diferencë e raportit aktual dhe atij potencial të kredive për ndërmarrjet ndaj BPV-së vjetore. Një normë e

²² Metoda standarde për vlerësimin e rrezikut nuk është adekuate për këtë nëntregues ngase seria kohore ka trend rënës dhe shpërndarja e të dhënave është shumë e koncentruar rreth mesatares. Në këtë rast kategoritë e rrezikut dallojnë pak dhe lëvizje të vogla në normë japin nota të ndryshme rreziku, si dhe observimi i fundit rezultoi në notë shumë të ulët të rrezikut për shkak të trendit rënës. Andaj për vlerësimin e rrezikut është përdorur gjykim profesional në përcaktimin e një metode alternative e cila përveç që synon të masë rrezikun nga ecuria e trendit të papunësisë, reflekton gjithashtu edhe rrezikun strukturor afatgjatë që paraqet norma e lartë e papunësisë. Në këtë rast, është përcaktuar kufiri maksimal i rrezikut që përkon me normën maksimale të papunësisë të shënuar në Kosovë (61%), dhe intervalet tjera janë përcaktuar duke ia zbritur nga një devijim standard intervalit paraprak.

²³ Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

²⁴ Intervali i rrezikut është kufizuar në notat 5-8 për shkak të serisë së shkurtër kohore, e cila fillon nga vitit 2013, dhe gjykimin profesional për përfaqësim më adekuat të rrezikut.

lartë pozitive e këtij raporti mund të sugjerojë akumulim të rrezikut kreditor nën supozimin se rritja e kreditimit bazohet në principe joprudente të kreditimit. Sidoqoftë, edhe raporti i kreditimit të ndërmarrjeve ndaj BPV-së në Kosovë qëndron në nivel relativisht të ulët²⁵, dhe ka hapësirë për rritje të mëtejme të këtij raporti duke pasur parasysh mesataren e këtij raporti në vendet e tjera. Andaj, në këtë studim, fokusi është në efektin afatshkurtër të nëntreguesit, me ç'rast hendeku pozitiv nënkupton rritje të financimit për sektorin e ndërmarrjeve dhe zhvillim të mëtejme të sektorit financiar. Notimi është i zhdrejtë: normë e lartë pozitive nënkupton rrezik më të ulët për stabilitetin financiar.

4.2. Cilësia e portofolit kreditor të ndërmarrjeve

Cilësia e portofolit kreditor të ndërmarrjeve është tregues i rëndësishëm i rrezikut kreditor të sektorit bankar si rezultat i ekspozimit në sektorin e ndërmarrjeve. Përkeqësimi i cilësisë së portofolit kreditor të ndërmarrjeve mund të sugjerojë performancë të përkeqësuar të sektorit të ndërmarrjeve dhe kapacitet më të ulët për kthimin e kredive, gjë e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në profitabilitetin dhe nivelin e kapitalizimit të sektorit bankar. Nëntreguesi i cilësisë së portofolit kreditor të ndërmarrjeve ndërtohet si raport i kredive joperformuese të ndërmarrjeve ndaj gjithsej kredive për këtë sektor. Notimi është i drejtë: rritja e raportit të kredive joperformuese paraqet rritje të rrezikut për stabilitetin financiar.²⁶

4.3. Indeksi i qarkullimit industrial

Ky nëntregues synon të masë aktivitetin ekonomik apo qarkullimin nga prodhimi në katër fusha të sektorit të industrisë, përkatësisht në industrinë nxjerrëse, përpunuese, furnizimin me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, si dhe furnizimin me ujë, veprimtarinë e menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave. Vlerësimi i aktivitetit në këta sektorë²⁷ është i rëndësishëm për matjen e rrezikut kreditor. Ky nëntregues ka për burim Agjencinë e Statistikave të Kosovës²⁸ dhe paraqitet në formë të mesatares së thjeshtë të indekseve në katër sektorët e lartcekur. Notimi është i zhdrejtë: rritja e vlerës së këtij indeksi tregon për rritje të qarkullimit në sektorin e industrisë dhe rënie të rrezikut kreditor.²⁹

4.4. Vlera e shtuar në sektorin e tregtisë

Spektori i tregtisë përbën sektorin me pjesëmarrjen më të lartë të kredive të ndërmarrjeve (52 % të gjithsej kredive për ndërmarrjet), prandaj vlerësimi i performancës së këtij sektori është i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut kreditor. Si matës i performancës së sektorit të tregtisë është marrë norma reale e rritjes vjetore të vlerës së shtuar në BPV-në nga aktiviteti i sektorit të tregtisë. Sa më e lartë që të jetë norma e rritjes së vlerës së shtuar nga sektori i tregtisë, aq më e mirë pritet të jetë performanca e ndërmarrjeve tregtare dhe, rrjedhimisht, aftësia e kthimit të kredive nga ndërmarrjet tregtare pritet të jetë më e lartë. Notimi për nëntreguesin është i

²⁵ Sipas të dhënave nga Banka Botërore, mesatarja e raportit të kreditimit të sektorit privat (ndërmarrje dhe ekonomi familjare) ndaj BPV-së për vendet e rajonit në vitin 2015 ishte 47%, ndërsa për Evropën dhe Azinë Qendrore ishte 95.9%. Për Kosovën, ky raport ishte 36.8%, më i ulët se mesatarja e vendeve me të ardhura të ulëta të mesme (ang: Low middle income countries) prej 45.6%.

²⁶ Intervali i rrezikut është kufizuar në notat 4-8 për shkak të serisë së shkurtër kohore dhe gjykimit profesional për përfaqësim më adekuat të rrezikut.

²⁷ Sipas të dhënave të qershorit 2016, pjesëmarrja e kredive të ndërmarrjeve që shkojnë në sektorin e minierave është 2%; sektorin e energjisë, gazit dhe të tjera 1.5%; ndërsa në prodhim 20%.

²⁸ Publikimi: Statistikat afatshkurtëra të Industrisë.

²⁹ Intervali i rrezikut është kufizuar në notat 4-8 për arsye si më lart.

zhdrejtë: një normë më e lartë e rritjes së vlerës së shtuar nga sektori i tregtisë nënkupton performancë më të mirë të sektorit të tregtisë dhe rrezik më të ulët për stabilitetin financiar.³⁰

4.5. Ecuria e ndërmarrjeve të reja dhe të mbyllura

Ky nëntregues paraqet diferencën e numrit të ndërmarrjeve të reja të regjistruara dhe atyre që mbyllen në një periudhë të caktuar, dhe është përfshirë si një tjetër përafrues i shëndetit të sektorit të ndërmarrjeve. Supozimi është se ndërmarrjet të cilat nuk janë profitabile për një periudhë të caktuar shuhen, ndërsa iniciativat ndërmarrëse të cilat kanë plane të mira të biznesit dhe prospekt pozitiv, formalizohen përmes regjistrimit në formën e ndërmarrjeve. Megjithatë veprimet e shlyerjes dhe regjistrimit mund të mos paraqesin situatën aktuale por janë pasojë e vështirësive në periudhat e më hershme ose pritjeve për të ardhmen, diferenca neto supozohet të ketë karakter sinjalizues për shëndetin e ndërmarrjeve në periudhën e ardhshme. Notimi për këtë nëntregues është i zhdrejtë: një normë e lartë pozitive (numër më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara se sa atyre të shuara), nënkupton rënie të rrezikut për sektorin financiar nga ana e ndërmarrjeve.

5. Qeveria

Zhvillimet në sektorin qeveritar kanë implikime të drejtpërdrejta në sektorin real dhe në sektorin financiar. Qeveria, përmes menaxhimit të politikës fiskale ndikon në nivelin dhe strukturën e kërkesës së përgjithshme në ekonomi si dhe në buxhetin e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare. Gjithashtu, qëndrueshmëria e sektorit fiskal ndikon në sektorin bankar përmes ekspozimit të bankave në borxhin publik dhe rolit që qeveria mund të ketë në menaxhimin dhe zgjidhjen e krizave të mundshme sistemike. Për më tepër, ndërlikohja e ngushtë mes bankave dhe financave publike krijon hapësirë për transmetim të rreziqeve nga njëri sektor në tjetrin, ku rritja eventuale e rrezikut sovran ndikon në rritjen e rrezikut real dhe atë të perceptuar për sektorin financiar, dhe anasjelltas (BIS, 2016). Nëntreguesit e përfshirë në këtë kategori përfshijnë aspekte të ndryshme të sektorit të qeverisë të cilat reflektojnë qëndrueshmërinë e borxhit të saj, qëndrueshmërinë e buxhetit si dhe rrezikun sovran:

5.1. Madhësia e borxhit publik

Ky nëntregues pasqyron raportin e borxhit publik ndaj BPV-së vjetore. Menaxhimi i borxhit publik ka ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë makroekonomike dhe stabilitetin financiar të vendit. Niveli i lartë i borxhit kufizon mundësinë e qeverisë për të ushtruar në mënyrë efikase politikë kundërciklike fiskale dhe për të mbështetur rritjen ekonomike. Gjithashtu, borxhi i lartë ndikon në perceptimin e rrezikut sovran nga investitorët që mund të rezultojë në rritje të kostos së borxhit publik dhe shtimin e presioneve në bilancin e gjendjes, të hyrat dhe nivelin e kapitalit të bankave që kanë investime në instrumente të borxhit publik, duke ndikuar kështu në stabilitetin financiar të tyre. Rrjedhimisht, notimi për nëntreguesin është i drejtë: një normë më e lartë e borxhit publik nënkupton ngarkesë më të madhe për buxhetin e qeverisë dhe perceptim më të lartë të rrezikut sovran, që paraqet rrezik më të lartë për stabilitetin financiar.³¹

³⁰ Intervali i rrezikut është kufizuar në notat 3-7 për arsyet si më lart.

³¹ Seria kohore e raportit të borxhit publik ndaj BPV-së është relativisht e shkurtër dhe ka trend rritës, andaj metoda standarde e vlerësimit nuk është adekuate. Për vlerësimin e këtij nëntreguesi është përdorur një metodë alternative ku është vendosur tavan i sipërm maksimal prej 40%, që korrespondon me normën referente maksimale të borxhit publik ndaj BPV-së të lejuar me Ligjin për Borxhin Publik, dhe intervalet ndërmjet 0-40% janë ndarë në nëntë pjesë të barabarta.

5.2. Kostoja e borxhit publik

Çmimi i borxhit që qeveria paguan ka ndikim në buxhetin e qeverisë dhe kapacitetin e saj për shlyerje të borxhit aktual dhe marrje të borxhit të ri. Rritja e ngarkesës për pagesa të borxhit mund të ndikojë në ristrukturimin e shpenzimeve të qeverisë të cilat mund të kenë efekt në të ardhurat e agjentëve ekonomikë në njërin anë, si dhe në rritjen e presioneve për arkëtimin në kohë të të hyrave për mbajtësit e bonove dhe obligacioneve qeveritare në anën tjetër. Situata të tilla paraqesin pengesë për zhvillimin e sektorit financiar dhe rrisin rrezikun kreditor të tij. Nëntreguesi i kostos së borxhit publik ndërtohet si raport i shpenzimeve të qeverisë për pagesën e interesit ndaj gjithsej borxhit publik. Notimi është i drejtë: rritja e raportit nënkupton rritje të çmimit që paraqet rritje të rrezikut për stabilitetin financiar.

5.3. Rreziku sovran

Rreziku sovran nënkupton rrezikun që qeveria nuk do të arrijë të realizojë në kohë pagesat për shlyerjen e borxhit apo të përmbushë obligimet kreditore sipas marrëveshjes. Paraqitja e problemeve eventuale në realizimin e pagesave të borxhit publik paraqet rrezik direkt për sektorin bankar i cili është investuesi kryesor në instrumentet e borxhit të qeverisë. Në rastin e Kosovës, si përfrues i rrezikut sovran është marrë dallimi ndërmjet normës së interesit të bonove të thesarit tremujore të Qeverisë së Kosovës si dhe atyre të Qeverisë së Gjermanisë, si ndër ekonomitë më stabile të eurozonës. Supozimi është që ndryshimi i diferencës në normën e kthimit reflekton ndryshim në rrezikun sovran në vend ngase bonot e qeverisë Gjermane konsiderohen si bono pa rrezik dhe ndryshimet në normën e kthimit të tyre karakterizohen me lëvizje të ulëta. Notimi për këtë nëntregues është i drejtë: rritja e rrezikut sovran nënkupton rritje të rrezikut për stabilitetin financiar.³²

5.4. Bilanci buxhetor i qeverisë

Ky nëntregues vlerëson shëndetin financiar të qeverisë në kuptimin e mbulueshmërisë së shpenzimeve me të ardhura qeveritare dhe është ndërtuar si raport i diferencës së të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore ndaj BPV-së vjetore. Në raste kur të ardhurat e qeverisë gjatë një viti janë më të ulëta se shpenzimet, bilanci buxhetor është negativ. Situatat e vazhdueshme të deficitit buxhetor mund të rezultojnë në probleme strukturore si akumulim të borxhit publik, rritje të normave të interesit për marrje të borxhit të ri si dhe zëvendësim apo përjashtim të investimeve private. Deficiti i lartë buxhetor mund gjithashtu të rezultojë në veprime si rritje të taksave dhe zvogëlim të shpenzimeve, të cilat krijojnë brishtësi në gjendjen makroekonomike të vendit dhe paraqesin rrezik për qëndrueshmërinë financiare. Andaj notimi është i zhdrejtë: rritja e bilancit buxhetor (suficiti buxhetor) ndaj BPV-së reflekton situatë të rënies së rrezikut për stabilitet financiar nga ana e qeverisë.

5.5. Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore janë burimi kryesor i të ardhurave buxhetore në Kosovë dhe ky nëntregues synon të vlerësojë kapacitetin e qeverisë për grumbullimin e këtyre të ardhurave. Nëntreguesi është shprehur si raport i të ardhurave tatimore ndaj BPV-së vjetore, në mënyrë që të reflektojë zgjerimin e bazës së të ardhurave tatimore. Notimi është i zhdrejtë: rritja e raportit reflekton

³² Për shkak të serisë së shkurtër kohore (seria kohore fillon nga viti 2012 kur Qeveria e Kosovës ka filluar me emetimin për herë të parë të Letrave me Vlerë), intervali i rrezikut është kufizuar në notat 2-6.

kapacitet të shtuar për grumbullim të tatimeve dhe ekonomi më të formalizuar, që paraqet rrezik më të ulët për ekonominë dhe stabilitetin financiar.

6. Struktura e sektorit bankar

Bankat e mëdha dhe me rëndësi sistemike për sektorin paraqesin vatra potenciale të rrezikut për stabilitetin financiar ngase problemet apo dështimi i mundshëm i tyre manifestohet me efekte përcjellëse dhe pasoja të rënda negative për funksionimin e gjithsej sektorit dhe ekonomisë së vendit. Treguesi i strukturës së sektorit bankar synon të vlerësojë rrezikun e mundshëm që mund të burojë nga struktura e sektorit apo rëndësia sistemike e bankave (dimensioni i madhësisë dhe zëvendësueshmërisë së institucioneve) dhe niveli i kapitalizimit për mbulimin e humbjeve nga goditjet e mundshme. Nëntreguesit e përzgjedhur më konkretisht reflektojnë koncentrimin e tregut, diversifikimin e investimeve dhe burimeve të fondeve, si dhe nivelin e kapitalizimit.

6.1. Koncentrimi i tregut të sektorit bankar

Ky nëntregues synon të matë shkallën e koncentrimin të tregut në sektorin bankar dhe shprehet si raport i aseteve të tri bankave më të mëdha ndaj aseteve të gjithsej sektorit. Literatura sa i përket ndërlidhjes së koncentrimin të tregut të sektorit bankar dhe stabilitetit financiar është e ndarë në dy mendime të kundërta. Njëri grup argumenton që koncentrimi më i lartë bankar përforcon stabilitetin ngase bankat që janë më të koncentruara realizojnë profit më të lartë i cili mundëson rritjen e kapitalit dhe rritë aftësinë e tyre për përballimin e goditjeve të mundshme; bankat me koncentrim të lartë të tregut nuk ndërmarrin aktivitete të rrezikshme meqenëse kanë burime të mira të të hyrave, por edhe në rastet kur koncentrimi rritë rrezikun e kredive, ky rrezik mund të mënjanohet nga pozita e mirë e kapitalit (Berger et al., 2009). Në anën tjetër, studiuesit argumentojnë që koncentrimi paraqet rrezik për stabilitetin financiar duke iu referuar kryesisht hipotezës së ‘shumë e madhe për të dështuar’ (ang: too big to fail). Koncentrimi i lartë iu krijon bankave mundësi për ndërmarrje të rrezikut për shkak të garancioneve implicite dhe eksplicite për shpëtimin e tyre në rast të krizave (Mishkin, 1999). Në përgjithësi, nuk ekziston pajtueshmëri e plotë mbi raportin ndërmjet konkurrencës dhe stabilitetit financiar. Pas krizës financiare të vitit 2008, hipoteza ‘shumë e madhe për të dështuar’ u aktualizua për shkak të rëndësisë që institucionet e mëdha financiare kanë në funksionimin e gjithsej sektorit financiar dhe efekteve të mëdha negative që përcillen në sektorin financiar dhe ekonominë në tërësi në rast të dështimit të tyre. Andaj, duke marrë parasysh që koncentrimi në kontekst të këtij punimi synon të masë rëndësinë sistemike të bankave, pritjet janë që sa më e lartë të jetë pesha e aseteve të tri bankave më të mëdha, aq më e lartë është ndjeshmëria e sektorit ndaj zhvillimeve negative nga këto banka. Rrjedhimisht, notimi është i drejtë: sa më i lartë koncentrimi bankar, aq më i lartë rreziku për stabilitetin financiar.³³

6.2. Koncentrimi i kredihënies për sektorin e ndërmarrjeve

Në tregun kreditor të Kosovës, pjesa më e madhe e kredive bankare përbëhet nga kreditë e lëshuara për ndërmarrjet. Gjithashtu, produktet kreditore të lëshuara për ndërmarrjet janë më të larmishmet në kuptimin e llojit të kredisë, qëllimit dhe maturitetit, gjë që mundëson pozicionimin apo profilizimin e bankave në produkte specifike brenda këtij segmenti.

³³ Metoda standarde e vlerësimit nuk është e përshtatshme për këtë nëntregues ngase shtrirja e të dhënave është e koncentruar rreth mesatares dhe një lëvizje e vogël sugjeron për ndryshim të madh rreziku. Andaj, është përdorur gjykimi profesional për përcaktimin e intervaleve të rrezikut: nota zero korrespondon me koncentrimin 0-20%, ndërsa nota 10 me koncentrimin mbi 80%. Intervalet e ndërmjetme janë ndarë në pjesë të barabarta.

Nëntreguesi i koncentrimin të kredidhënies për sektorin e ndërmarrjeve synon të masë koncentrimin e kreditimit për ndërmarrje, duke u bazuar në parimin që koncentrimi rritë rrezikun ngase në rast të problemeve të mundshme me këto banka, kreditimi në segmentet në të cilat ato banka kanë dominuar është i vështirë të zëvendësohet nga bankat tjera dhe efektet negative për ekonominë dhe sektorin financiar janë më të mëdha. Në këtë rast, koncentrimi i kreditimit për ndërmarrjet është shprehur si raport i kreditimit për këtë segment nga banka me pjesëmarrjen më të lartë të kredive të ndërmarrjeve ndaj shumës së kreditimit për ndërmarrje të katër bankave të radhës me pjesëmarrjen më të lartë. Notimi është i drejtë: sa më i lartë të jetë raporti, aq më i koncentruar kreditimi ndaj ndërmarrjeve dhe rrjedhimisht, aq më i lartë rreziku për stabilitetin financiar.³⁴

6.3. Devijimi i strukturës së kreditimit të bankave ndaj strukturës së tregut

Bankat që kanë strukturë të njëjtë të kreditimit janë të ekspozuara ndaj kategorive të njëjta huamarrësish, ndaj dhe ndikohen në të njëjtën mënyrë nga goditjet ekonomike. Diversifikimi i ulët i kreditimit do të rezultonte në ndjeshmëri më të lartë të sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme. Për këtë arsye është ndërtuar ky nëntregues që vlerëson se sa e shpërndarë është struktura e kredisë brenda sektorit bankar duke u bazuar në llogaritjen e variancës midis ekspozimit të secilës bankë dhe ekspozimit mesatar të sektorit bankar. Metoda e ndërtimit të nëntreguesit është bazuar në punimin e Dahl et al. (2011) si dhe Saqe et al. (2015): Portfolio kreditore është ndarë në tri nëngrupe: 1) kredi ndaj sektorit privat; 2) kredi ndaj sektorit publik; dhe 3) kredi ndaj ekonomive familjare. Pastaj është llogaritur ndryshimi ndërmjet strukturës së kredisë së secilës bankë dhe strukturës së kredisë të sektorit. Në fund është llogaritur varianca e këtyre diferencave duke u bazuar në pjesëmarrjen e kreditimit të secilës bankë në gjithsej kreditimin e sektorit. Notimi i këtij nëntreguesi është i zhdrejtë: Sa më e lartë të jetë varianca aq më e diversifikuar është struktura e kreditimit të sektorit bankar, që rrjedhimisht nënkupton rezistencë më të lartë të sektorit ndaj goditjeve eventuale dhe rrezik më të ulët për sektorin bankar dhe stabilitetin financiar.³⁵

6.4. Devijimi i strukturës së fondeve të bankave ndaj strukturës së tregut

Ky nëntregues synon të vlerësoj diversifikimin në aspektin e burimeve të fondeve. Ndërtimi i tij është i ngjashëm me atë të diversifikimit të kredisë. Për çdo bankë si dhe për gjithsej sektorin burimet e financimit ndahen në gjashtë nëngrupe duke përjashtuar burimet vetanake: 1) bilanci nga bankat komerciale; 2) depozitat e transferueshme; 3) depozitat e afatizuara; 4) depozitat e kursimit; 5) borxhi i ndërvarur dhe 6) huazimet e tjera. Pastaj është llogaritur ndryshimi ndërmjet strukturës së fondeve të financimit të secilës bankë dhe strukturës së fondeve të sektorit. Në fund është llogaritur varianca e këtyre diferencave duke u bazuar në pjesëmarrjen e fondeve të secilës bankë në gjithsej financimin e sektorit bankar. Notimi i këtij nëntreguesi është i zhdrejtë: Sa më e lartë të jetë varianca aq më e diversifikuar është struktura e fondeve të sektorit bankar, që rrjedhimisht nënkupton rezistencë më të lartë të sektorit ndaj goditjeve eventuale dhe rrezik më të ulët për stabilitetin financiar.³⁶

³⁴ Metoda standarde e vlerësimit nuk është e përshtatshme as për këtë nëntregues për arsyet e njëjta si për nëntreguesin paraprak. Andaj, intervalet e rrezikut përcaktohen në bazë të gjyqimit profesional: rreziku minimal kur nëntreguesi ka vlerë nën 10%, ndërsa maksimal në rast se kreditimi i bankës me pjesëmarrjen më të lartë është më i lartë se gjithsej kreditimi i katër bankave të radhës me pjesëmarrjen më të lartë.

³⁵ Për shkak që seria kohore e devijimeve është relativisht e shkurtër atëherë është përdorur një metodë alternative ku përcaktohen intervalet e rrezikut në bazë të gjyqimit. Nota e rrezikut është kufizuar në kufijtë 4-6 dhe intervali ndërmjet tyre është ndarë në pjesë të barabarta.

³⁶ Për shkak që seria kohore e devijimeve është relativisht e shkurtër, është përdorur metoda alternative e vlerësimit. Nota me rrezik maksimal është përcaktuar të jetë 6, ndërsa ajo me rrezik minimal është përcaktuar të jetë 4 dhe intervali ndërmjet tyre është ndarë në pjesë të barabarta.

6.5. Devijimi i normës së kapitalizimit të bankave ndaj normës së kapitalizimit të gjithsej sektorit

Qëllimi i këtij nëntreguesi është që të masë devijimet e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave nga norma mesatare e kapitalizimit të sektorit bankar, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e normës mesatare të kapitalizimit të sektorit. Bankat në Kosovë kërkohen me rregullore që të mbajnë nivelin e kapitalit rregullativ ndaj aseteve të peshuara me rrezik mbi nivelin minimal të lejuar prej 12%. Sidoqoftë, bankat mund të qëndrojnë më pranë pragut minimal dhe më larg prej nivelit mesatar të sektorit ngase mund të ketë raste kur norma mesatare ndikohet nga kapitalizimi i disa bankave më të mëdha. Në këtë rast, sa më të mëdha dallimet negative mes nivelit të kapitalit të bankave individuale dhe normës mesatare të kapitalizimit të sektorit, aq më i ndjeshëm vlerësohet të jetë sektori nga goditje të mundshme. Për llogaritjen e këtij nëntreguesi është marrë varianca e ndryshimeve midis normës së kapitalizimit të bankave dhe mesatares së sektorit vetëm për bankat të cilat gjenden nën normën mesatare të sektorit bankar.³⁷ Varianca është llogaritur e ponderuar duke marrë parasysh peshën e aseteve të secilës bankë ndaj gjithsej aseteve të sektorit, ngase devijimi negativ për një bankë më të madhe paraqet rrezik më të lartë për sektorin në krahasim me një bankë më të vogël. Notimi i këtij nëntreguesi është i drejtë: varianca më e lartë nënkupton devijim më të lartë negativ ndaj normës mesatare të kapitalizimit dhe rrezik më të lartë për stabilitetin financiar.

7. Kapitalizimi dhe profitabiliteti i sektorit bankar

Kapitalizimi dhe profitabiliteti i bankave është tregues shumë i rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të rrezikut për sektorin bankar dhe që ka implikime direkte në stabilitetin financiar. Profitabiliteti tregon potencialin e bankave për të realizuar profit dhe për të rritur kapitalin e tyre përmes këtij profiti, ndërsa kapitalizimi shpreh aftësinë e bankave për të absorbuar humbjet e mundshme. Ky tregues ndërtohet nga gjashtë nëntregues kryesorë që monitorohen në vazhdimësi për vlerësimin e ndjeshmërisë së sektorit nga goditjet e jashtme dhe të cilët reflektojnë më së miri gjendjen e kapitalizimit të bankave, cilësinë e portfolios kreditore të tyre dhe profitabilitetin.

7.1. Mjaftueshmëria e kapitalit rregullativ

Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit³⁸ është një ndër indikatorët kryesorë të shëndetit financiar të bankave. Rregullorja e BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit përcakton nivelin minimal të normës së kapitalit që bankat duhet të mbajnë në çdo kohë në mënyrë që të jenë të afta për të absorbuar humbjet e mundshme.³⁹ Nëntreguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është llogaritur si diferencë ndërmjet normës aktuale të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar dhe normës minimale të lejuar sipas rregullores. Diferenca më e ulët nënkupton mbulim më të vogël të aseteve me kapital që rrjedhimisht nënkupton ndjeshmëri më të lartë të sektorit ndaj goditjeve eventuale dhe anasjelltas. Notimi për këtë nëntregues është i zhdrejtë: një diferencë më e ulët sinjalizon rrezik më të lartë për sektorin bankar.

³⁷ Metoda e ndërtimit të këtij nëntreguesit gjithashtu është bazuar në punimin e Dahl et al. (2011) si dhe Saqe et al. (2015)

³⁸ Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit llogaritet si raport i Kapitalit rregullator ndaj aseteve të peshuara me rrezik.

³⁹ Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullator në raport me Asetet e Peshuara me Rrezik dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me APR.

7.2. Kapitali aksionar i sektorit

Raporti i kapitalit aksionar ndaj asetëve të bankës tregon pjesën e asetëve bankare të financuar nga kapitali i aksionarëve. Ky raport përdoret si vlerësues i nivelit të borxhit (ang: leverage ratio) të bankës. Megjithatë financimi i bankës nga mjete të huazuara është i dëshirueshëm, pjesëmarrje e caktuar e financimit nga burimet vetanake është i domosdoshëm për të siguruar besueshmëri dhe qëndrueshmëri të sektorit. Kjo ngase kapitali aksionar është burimi më i qëndrueshëm i financimit të bankës dhe paraqet kategorinë e parë që shfrytëzohet për përballimin e humbjeve të mundshme të bankës. Atëherë, raport më i lartë i kapitalit aksionar ndaj asetëve nënkupton cilësi më të mirë të kapitalit dhe kapacitet më të lartë të bankave për mbulimin e humbjeve eventuale. Notimi për këtë nëntregues është i zhdrejtë: një raport më i lartë sinjalizon rrezik më të ulët për sektorin bankar.

7.3. Kreditë joperformuese të sektorit

Cilësia e portofolit kreditor të bankave është ndër matësit më të rëndësishëm të rrezikut kreditor të bankave. Vlerësimi i cilësisë së portofolios kreditor bëhet kryesisht përmes raportit të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive. Përkeqësimi i cilësisë kreditor shprehet përmes rritjes së raportit të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive, gjë e cila nënkupton që bankat duhet të ndajnë më shumë provizione për të mbuluar humbjet nga moskthimi i kredive. Kjo do të ketë efekt direkt në bilancin e bankave ku më shumë kapital do të duhej të ndahet për provizione. Prandaj notimi për këtë nëntregues është i drejtë: një normë më e lartë e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive paraqet rrezik më të lartë kreditor dhe sinjalizon rrezik më të lartë për stabilitetin financiar.

7.4. Të ardhurat neto nga interesi

Ky nëntregues synon të vlerësojë efikasitetin e “shfytëzimit” të asetëve për gjenerimin e të ardhurave nga interesi, dhe ndërtohet si raport i të ardhurave nga interesi ndaj gjithsej asetëve. Duke qenë se të ardhurat neto nga interesi përbëjnë kategorinë kryesore të të ardhurave të sektorit bankar, pjesëmarrja më e lartë në gjithsej asetet e sektorit do të nënkuptonte rritje të efikasitetit të investimeve të bankës (rritje të normës së kthimit ose rritje të pjesëmarrjes së asetëve që gjenerojnë të hyra). Notimi është i zhdrejtë: një raport më i lartë nënkupton rritje të të hyrave dhe rënie të rrezikut për sektorin bankar.

7.5. Profitabiliteti i sektorit

Profiti i lartë i realizuar do të thotë aftësi e bankave për të rritur kapitalin e tyre. Prandaj, matja e profitabilitetit është me rëndësi për vlerësimin e nivelit të rrezikut për stabilitetin financiar që mund të rrjedhë nga sektori bankar. Nëntreguesi i profitabilitetit është shprehur si raport i fitimit para tatimit ndaj gjithsej asetëve, me ç’rast është marrë parasysh fitimi para tatimit në mënyrë që ndryshimet në normat tatimore të mos ndikojnë vlerësimin real të fitimit apo humbjes së bankave. Notimi ka kahje të zhdrejtë: një raport më i ulët nënkupton rrezik më të lartë për stabilitetin financiar.

7.6. Ekspozimet e mëdha

Diversifikimi i ekspozimeve kreditor është një aspekt mjaft i rëndësishëm për menaxhimin e rrezikut kreditor që ka implikime në stabilitetin financiar në përgjithësi. Kjo duke marrë parasysh që në rast të përqendrimit të lartë të ekspozimeve kreditor ndaj huamarrësve

individual apo një grupi të ndërlidhur huamarrësish, dështimi i papritur i këtyre palëve do ta rrezikonte bankën përmes rritjes së konsiderueshme të kredive jo performuese për shkak të peshës së lartë të ekspozimit. Kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti në rënien e nivelit të përgjithshëm të kapitalizimit dhe profitabilitetit. Vlerësimi i ekspozimeve të mëdha kreditore trajtohet nga rregullorja e BQK-së⁴⁰ e cila kufizon nivelin e ekspozimeve të bankave ndaj kapitalit rregullativ, prandaj ky nëntregues ndërtohet si raport i ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë. Notimi është i drejtë: sa më i lartë të jetë ky raport aq më i përqendruar është ekspozimi kreditor dhe rrjedhimisht më i lartë rreziku për sektorin bankar.

8. Likuiditeti dhe Financimi

Kategoria e likuiditetit dhe financimit ka për synim vlerësimin e rreziqeve ndaj sektorit bankar që mund të shkaktohen si pasojë e strukturës së burimeve të financimit dhe likuiditetit të sektorit bankar. Sa më të ndjeshme që janë burimet e financimit të bankës ndaj ndryshimeve në tregje vendore dhe ndërkombëtare, aq më i lartë rreziku i financimit të bankës. Gjithashtu, mjaftueshmëria e mjeteve likuide është esenciale në sigurimin e funksionimit të sektorit dhe përmbushjen e kërkesave afatshkurtra të klientëve, andaj maturiteti i burimeve të financimit është aspekt i rëndësishëm dhe vatër e mundshme rreziku për bankën. Burimet afatgjata të financimit janë më të qëndrueshme ndaj goditjeve në tregje, si dhe kontribuojnë në mbajtjen e baraspeshës në hendekun e likuiditetit si pasojë e strukturës së biznesit të bankave të cilat financojnë investimet afatgjata (kreditë) me burime afatshkurtra të financimit. Treguesi i likuiditetit dhe financimit ndërtohet nga pesë nëntregues të cilët synojnë të vlerësojnë qëndrueshmërinë e burimeve të financimit dhe pozitën e likuiditetit në aspektin e mjaftueshmërisë së mjeteve likuide për mbulimin e detyrimeve afatshkurtra.

8.1. Mbulueshmëria e kredive me depozita

Mbulueshmëria e kredive me depozita, e shprehur përmes raportit të gjithsej kredive të sektorit ndaj gjithsej depozitave, vlerëson nivelin e likuiditetit të sektorit bankar dhe potencialin e bankave për të rritur kreditimin. Raport i lartë do të thotë mbulim më i vogël me financim nga depozitat të cilat cilësohen si burimi më i qëndrueshëm i financimit për bankat, dhe më pak mundësi që bankat të zgjerojnë më tej kreditimin. Prandaj notimi i këtij nëntreguesi është i drejtë: një raport më i lartë sinjalizon likuiditet më të ulët, pra rrezik në rritje për stabilitetin financiar.

8.2. Depozitat e ekonomive familjare

Depozitat e ekonomive familjare paraqesin burimin kryesor të financimit të sektorit bankar në Kosovë. Në kushte normale, depozitat e ekonomive familjare konsiderohen si burimi më i qëndrueshëm i financimit për bankat ngase përbëjnë shuma më të vogla nga një numër i madh i individëve të cilët kanë probabilitet shumë të ulët për të tërhequr depozitat e tyre në kohën e njëjtë. Ndërsa, në kushte jostabiliteti apo paniku financiar, depozitat e ekonomive familjare janë ndër burimet më të ndjeshme të financimit. Prandaj, trendi i depozitave të ekonomive familjare mund të konsiderohet si matës i nivelit të likuiditetit të bankave në njërin anë, si dhe besueshmërisë së sektorit në anën tjetër. Ky nëntregues shprehet si ndryshim vjetor i nivelit të depozitave të ekonomive familjare, me ç'rast rritja e tyre nënkupton rritje të likuiditetit, që

⁴⁰ Sipas Rregullores mbi Ekspozimet e Mëdha, neni 3, paragrafi 3 kufizimi prej treqind për qind (300%) të kapitalit të klasit I për ekspozimet e mëdha të grumbulluara kreditore, do të zbatohet për të gjitha ekspozimet ndaj personit apo grupeve të personave, kur secili nga ata e tejkalon dhjetë për qind (10%) të Kapitalit të Klasit të I të bankës.

rrjedhimisht reflekton besueshmëri dhe qëndrueshmëri të sektorit bankar. Notimi i këtij nëntreguesi është i zhdrejtë. Sa më e lartë norma e rritjes, aq më i ulët rreziku i likuiditetit të sektorit.

8.3. Detyrimet ndaj jo-rezidentëve

Sektor i bankar i Kosovës, megjithëse në pjesëmarrje të vogël, shfrytëzon edhe burime të jashtme për financimin e bilancit të tij të gjendjes. Detyrimet ndaj jo-rezidentëve janë burim i financimit që karakterizohet me ndjeshmëri të lartë si ndaj goditjeve të brendshme, ashtu edhe nga goditjet në nivel ndërkombëtar. Në përgjithësi, mjetet nga jo-rezidentët konsiderohen mjaft të ndjeshme ndaj kushteve të tregut, prandaj në kushte të pafavorshme, jo-rezidentët mund të tërheqin mjetet e tyre jashtë vendit, çka do të rriste rrezikun për sektorin bankar sidomos në rastet kur bankat kanë nivel të lartë të financimit nga jo-rezidentët. Nëntreguesi i detyrimeve nga jorezidentët është ndërtuar si raport i gjithsej financimit nga jo-rezidentët (depozita, kredi dhe të tjera) ndaj gjithsej detyrimeve⁴¹ të sektorit bankar. Notimi i këtij nëntreguesi është i drejtë: një raport më i lartë i detyrimeve nga jo-rezidentët nënkupton varësi më të lartë të sektorit bankar nga burime të ndjeshme të financimit dhe rrezik më të lartë për stabilitetin financiar.⁴²

8.4. Raporti i likuiditetit

Raporti i likuiditetit, i shprehur si raport i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra ka për qëllim vlerësimin e rrezikut të financimit afatshkurtër të sektorit bankar. Asetet likuide në këtë rast përfshijnë mjetet likuide me maturim deri në tre muaj, ndërsa detyrimet afatshkurtra përfshijnë burimet e huazuara të financimit me maturim deri në një vit. Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra përdoret si vlerësues i aftësisë së bankës për të mbuluar nevojat e menjëhershme për likuiditet që mund të dalin si pasojë e goditjeve të mundshme afatshkurtra të likuiditetit. Norma më e lartë nënkupton që banka ka asete në dispozicion për të mbuluar kërkesat e menjëhershme të depozitorëve apo palëve tjera kreditore të bankës. Notimi ka kahje të zhdrejtë: Një normë më e ulët e raportit nënkupton mbulim më të vogël të detyrimeve afatshkurtra me asete likuide që paraqet rrezik më të lartë për stabilitetin financiar.⁴³

8.5. Hendeku i likuiditetit

Hendeku i likuiditetit është një tregues tjetër që ka për qëllim vlerësimin e rrezikut të likuiditetit që mund të paraqitet si pasojë e mospërputhjes së maturitetit të aseteve dhe detyrimeve të bankës. Ky nëntregues është ndërtuar si diferencë në mes të aseteve afatshkurtra dhe detyrimeve afatshkurtra të afatit të maturimit deri në 3 muaj. Modeli i biznesit të bankës bazohet në transformimin e maturitetit të mjeteve, me ç'rast burimet afatshkurtra të financimit përdoren për investime më afatgjata, andaj dhe hendeku negativ në periudha afatshkurtra është i pritshëm. Sidoqoftë, një nivel i lartë i hendekut negativ mund të sugjerojë për pozitë më të ndjeshme të likuiditetit ngase sektori bankar ka 'mungesë' të aseteve afatshkurtra për përmbushje të kërkesave afatshkurtra për likuiditet. Rrjedhimisht, sektori do të jetë më i

⁴¹ Gjithsej detyrimet e sektorit bankar, përfshirë burimet vetanake.

⁴² Metoda standarde nuk është adekuate për vlerësimin e këtij nëntreguesi meqenëse shpërndarja e të dhënave nuk është normale (të dhëna të skajshme), dhe për ndryshim të vogël të vlerave të treguesit ndryshojnë notat e rrezikut. Prandaj është përdorur metoda alternative, e bazuar në punimin e Dahl et al. (2011), ku është përcaktuar mesatarja e serisë kohore dhe devijimi standard. Mesatarja e serisë kohore është vlerësuar me notën 5 dhe çdo intervali mbi mesatare i është shtuar vlera e devijimit standard, ndërsa çdo interval nën mesatare është zvogëluar për atë vlerë të devijimit standard të serisë.

⁴³ Sipas rregullores së BQK-së rekomandohet që ky raport të jetë jo më pak se 25 përqind. Pasi që një raport nën vlerën 25 përqind paraqet rrezik të lartë si dhe për shkak të serisë më të shkurtër kohore, për shndërrimin e serisë së këtij nëntreguesi në nota rreziku është përdorur metodë alternative. Fillimisht është vendosur tavan i poshtëm minimal prej 25% (e vlerësuar me notë rreziku 10) dhe maksimal prej 50% (e vlerësuar me notë rreziku 0) ndërsa intervalet ndërmjet 25% - 50% janë ndarë në nëntë pjesë të barabarta të cilat marrin nota rreziku me kahje nga 9 në 1.

kufizuar në rritjen e kreditimit i cili kryesisht ka maturitet afatgjatë, ngase do të zvogëlonte edhe më tej mbulesën e detyrimeve afatshkurtra me asete likuide. Notimi ka kahje të drejtë ngase është marrë vlera absolute e hendekut, ku vlera më e lartë e tij sinjalizon mospërputhje më të lartë dhe rrezik më të madh për stabilitetin financiar.


V. Performanca e treguesve të mesatarizuar

Për të analizuar zhvillimet në kategoritë përkatëse të rrezikut, është ndërtuar treguesi i mesatarizuar për çdo kategori duke marrë mesataren e thjeshtë të vlerave të rrezikut të secilit nëntregues. Mungesa e të dhënave historike për shumë prej nëntreguesve bënë që ndërtimi i shumicës së treguesve të mesatarizuar për periudhën 2000-2008 të mos përputhet me kriterin e përfshirjes të së paku katër nëntreguesve. Mirëpo, ky kriter plotësohet për periudhën pas vitit 2008, me ç'rast treguesit në mesatarizimin e tyre përfshijnë së paku katër nëntregues. Në këtë seksion, analizohet trendi i treguesve të mesatarizuar si dhe në rastet ku ka të dhëna, analizohet performanca e treguesve në sinjalizimin e krizave.

Treguesi i mesatarizuar i ekonomisë së jashtme karakterizohet me trend rënës të rrezikut në periudhën para krizës globale (figura 2).⁴⁴ Rreziku fillon të rritet në TM4 2007 që përkon me fillimin e krizës, dhe arrin pikën maksimale në TM4 2009. Pas një periudhe të rënies së rrezikut në vitin 2010, si rrjedhojë e masave të qeverive dhe bankave qendrore për tejkalimin e krizës, rreziku përsëri rritet si pasojë e efekteve të krizës së borxhit në ekonomitë e eurozonës. Të gjithë nëntreguesit kontribuan në rritjen e rrezikut në këtë periudhë. Pas rënies së rrezikut në nivel mjaft të ulët në TM4 2015, viti 2016⁴⁵ karakterizohet me ngritje të lehtë të rrezikut që buron nga rritja e rrezikut në të gjithë nëntreguesit me përjashtim të normave bazë të interesit të cilat vazhduan trendin rënës.


Rreziku nga ekonomia e brendshme karakterizohet kryesisht me trend të lehtë rritës dhe lëvizje mbi nivelin mesatar të rrezikut (figura 3).⁴⁶ Periudha e krizës financiare 2007-2008 karakterizohet me rritje të rrezikut në ekonominë e brendshme, kryesisht si rezultat i rritjes së inflacionit dhe deficitit të llogarisë rrjedhëse. Rritja e rrezikut vazhdon tutje dhe në vitin 2010 arrin pikën më të lartë, kryesisht si rezultat i rritjes së hendekut të prodhimit. Viti 2014 gjithashtu karakterizohet me rrezik më të lartë si rezultat i ngadalësimit të rritjes ekonomike në vend, rritjes së deficitit të

Figura 2. Ekonomia e jashtme



Burimi: BQK (2016)

Figura 3. Ekonomia e brendshme



Burimi: BQK (2016)

⁴⁴ Treguesi i mesatarizuar i ekonomisë së jashtme reflekton performancën e pesë nëntreguesve, të dhënat e të cilëve janë të plota dhe janë përfshirë nga viti 2005, gjë që mundëson analizimin e performancës së këtij treguesi në sinjalizimin e rrezikut nga krizat dhe situatat e stresit financiar.


⁴⁵ Të dhënat e fundit për BPV-në e partnerëve tregtarë dhe papunësinë e vendeve me numrin më të madh të diasporës janë për TM1 2016.

⁴⁶ Treguesi i ekonomisë së brendshme ndërtohet nga mesatarizimi i performancës së gjashtë nëntreguesve. Periudha 2003-2004 paraqet vetëm performancën e nëntreguesit të inflacionit. Nga viti 2005 përfshihen zhvillimet edhe në dy nëntregues: hendeku i prodhimit si dhe bilanci i llogarisë rrjedhëse. Ndërsa, në vitin 2007 dhe 2008 përfshihen edhe zhvillimet në madhësinë e borxhit të jashtëm, kualitetin e institucioneve gjyqësore dhe luhatshmërinë e kursit të këmbimit.

Ilogarisë rrjedhëse si dhe zhvlerësimit të euros, ndërsa rritja më e lartë ekonomike në vitin 2015 dhe prospektet pozitive për vitin 2016 zvogëlojnë rrezikun nga ekonomia e brendshme afër nivelit mestar historik.

Niveli i rrezikut nga ekonomitë familjare qëndron kryesisht mbi nivelin mesatar, me tendenca të lehta rënëse dhe ngritjeje si rezultat i zhvillimeve të ndryshme në nëntreguesit përbërës (figura 4).⁴⁷ Rreziku nga cilësia e portofolit dhe dërgesat e emigrantëve kanë trend të përgjithshëm rritës, ndërsa papunësia dhe përballueshmëria e shpenzimeve trend rënës. Rreziku nga nëntreguesi i huamarrjes ka trend përgjithësisht rënës si rezultat i rritjes së raportit të kreditimit të ekonomive familjare ndaj BPV-së dhe ecurisë

Figura 4. Ekonomitë familjare




Burimi: BQK (2016)

pozitive të konvergimit të tij ndaj normave të vendeve të rajonit. Rreziku nga dërgesat e emigrantëve ka shënuar rritje të theksuar në periudhat e fundit, që nga TM4 2015 e tutje, si rezultat i rënies vjetore me të cilën po karakterizohen dërgesat. Në periudhën e fundit, rreziku i përgjithshëm nga sektori i ekonomive familjare qëndron pak mbi nivelin e mesatares historike.⁴⁸

Treguesi i mesatarizuar i ndërmarrjeve karakterizohet me disa cikle me rrezik mbi nivelin mesatar (figura 5).⁴⁹ Rreziku në pikën më të ulët ishte në vitin 2004 që reflektohet nga hapja e numrit më të madh të bizneseve duke sugjeruar për klimë optimiste të ndërmarrjeve biznese. Ndërsa, pikën më të lartë e arrin në fund të vitit 2006 që përkon me periudhën kur numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte më i ulët krahasuar me gjithë periudhën e përfshirë në analizë. Kreditimi i ndërmarrjeve në këtë periudhë ishte më i ulët se potenciali i tij afatgjatë, që sugjeron për zhvillim më të ulët të sektorit dhe rrezik më të lartë të perceptuar nga bankat për kapacitetin e ndërmarrjeve për thithje të fondeve. Periudha e krizës financiare 2008-2009 përkon me periudhën me rrezik më të ulët, që përkon me faktin se ekonomia e Kosovës ka qenë e mbrojtur nga efektet e menjëhershme të krizës, pasojat indirekte të së cilës janë ndjerë në periudhat e mëvonshme. Nga viti 2010, rreziku është karakterizuar me oscilime rreth mesatares dhe përgjithësisht me trend të lehtë rritës të ndikuar nga rritja e kredive joperformuese dhe rënia e numrit të ndërmarrjeve të reja të hapura. Në vitet e fundit, 2015-2016, niveli i rrezikut nga

Figura 5. Ndërmarrjet



Burimi: BQK (2016)

ndërmarrjeve në këtë periudhë ishte më i ulët se potenciali i tij afatgjatë, që sugjeron për zhvillim më të ulët të sektorit dhe rrezik më të lartë të perceptuar nga bankat për kapacitetin e ndërmarrjeve për thithje të fondeve. Periudha e krizës financiare 2008-2009 përkon me periudhën me rrezik më të ulët, që përkon me faktin se ekonomia e Kosovës ka qenë e mbrojtur nga efektet e menjëhershme të krizës, pasojat indirekte të së cilës janë ndjerë në periudhat e mëvonshme. Nga viti 2010, rreziku është karakterizuar me oscilime rreth mesatares dhe përgjithësisht me trend të lehtë rritës të ndikuar nga rritja e kredive joperformuese dhe rënia e numrit të ndërmarrjeve të reja të hapura. Në vitet e fundit, 2015-2016, niveli i rrezikut nga

⁴⁷ Treguesi i mesatarizuar i ekonomive familjare është ndërtuar nga pesë nëntregues. Të dhënat për vitin 2000-2005 paraqesin vetëm performancën e nëntreguesit të papunësisë. Ndërsa nga viti 2005 fillon edhe nëntreguesi i huamarrjes së ekonomive familjare. Të dhënat për të gjithë nëntreguesit paraqiten vetëm nga viti 2012.


⁴⁸ Të dhënat e fundit për papunësinë dhe përballueshmërinë e shpenzimeve nga ekonomitë familjare janë të periudhës TM4 2015.

⁴⁹ Treguesi i mesatarizuar i ndërmarrjeve ndërtohet nga të dhënat për pesë nëntregues. Periudha deri në vitin 2010 reflekton zhvillimet në vetëm dy nëntregues (huamarrjen e ndërmarrjeve dhe evidencën e diferencës së ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara). Nëntreguesit e tjerë përfshihen nga viti 2011.

ndërmarrjet priret të ketë tendencë të përmirësimit duke qëndruar nën mesataren e periudhës së përfshirë në analizë kryesisht si rezultat i hendekut pozitiv të kreditimit dhe përmirësimit të cilësisë së portofolit kreditor. Ndërsa, nëntreguesi i vlerës së shtuar në BPV nga sektori i tregtisë ka shënuar rritje të rrezikut si rrjedhojë e ngadalësimit të theksuar të aktivitetit në këtë sektor.

Rreziku nga sektori i qeverisë qëndron kryesisht nën nivelin mesatar dhe ka trend të lehtë rënës (figura 6).⁵⁰ Në periudhën TM4 2007 dhe TM2 2008, që përkon me periudhën e fillimit të krizës globale financiare, rreziku shënon vlerat minimale si rezultat i rritjes së të ardhurave tatimore. Në TM4 2008, rreziku ngritet pak mbi nivelin mesatar si rezultat i rritjes së deficitit fiskal, por që menjëherë shënon rënie. Në periudhën 2009-2015, rreziku nga qeveria ka treguar tendencë të lehtë rritëse, si rezultat i trendit rritës të madhësisë së borxhit dhe kostos së tij. Mirëpo, në TM2 2016 rreziku nga qeveria ka shënuar rënie si rezultat i rënies së rrezikut në pothuajse të gjithë komponentët, me theks të veçantë në deficitin fiskal dhe të ardhurat tatimore ndaj BPV-së.


Figura 6. Qeveria



Burimi: BQK (2016)

Rreziku nga struktura e sektorit bankar ka trend të përgjithshëm rënës. Pika më e lartë e rrezikut është shënuar në vitin 2008 (figura 7).⁵¹ Në periudhën 2008-2010, shkalla e koncentrimit të tregut ishte në nivelin më të lartë, kur asetet e tri bankave më të mëdha përbënin rreth 90 përqind të gjithë asetëve të sektorit bankar. Më pas, rreziku nga koncentrimi i tregut bankar shënoi rënie si rezultat i futjes në treg të bankave të reja dhe rritjes së konkurrencës në këtë sektor. Në përgjithësi, treguesi shfaq trend rënës të rrezikut, si rezultat i trendit rënës të rrezikut në të gjithë nëntreguesit (rritje e konkurrencës bankare, diversifikim i portfolios kreditorë, zgjerim i strukturës së burimeve të financimit, si dhe rritje e profitabilitetit që rrjedhimisht ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë së kapitalit të bankave). Në periudhën 2009-2012, e cila u karakterizua me rrezik mbi nivelin mesatar, përveç nivelit të lartë të koncentrimit të tregut ndikim kishin edhe diversifikimi më i ulët i kreditimit të bizneseve si dhe niveli i kapitalizimit i cili arrinë pikën kulmore të rrezikut në fund të vitit 2011 dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012. Ky rezultat përkon me rënie e normave të kapitalizimit, të cilat u ndikuan si nga profitabiliteti më i ulët i bankave në atë periudhë, ashtu edhe nga ndryshimet rregullative që u ndërmorën nga BQK-ja në vitin 2012, të cilat ndryshuan mënyrën e kalkulimit të kapitalit rregullativ dhe quan në zvogëlimin e treguesve

Figura 7. Struktura e sektorit bankar



Burimi: BQK (2016)

⁵⁰ Treguesi i mesatarizuar i Qeverisë ndërtohet nga pesë nëntregues. Periudha 2005-2008 reflekton vetëm zhvillimet në nëntreguesit e madhësisë së deficitit fiskal dhe raportit të ardhurave tatimore ndaj BPV-së. Nga viti 2009 shtohen edhe dy nëntregues tjerë, ndërsa primi i rrezikut sovran përfshihet nga viti 2012.


⁵¹ Treguesi i mesatarizuar i Strukturës së Sektorit Bankar është ndërtuar nga pesë nëntregues. Të dhënat për nëntreguesin e koncentrimit bankar (asetet e tri bankave ndaj gjithë asetëve të sektorit) dhe për devijimin e kapitalizimit nga norma mesatare datojnë nga viti 2008, ndërsa tre nëntreguesit tjerë fillojnë nga viti 2010.

të kapitalizimit. Në vitin 2013, shkalla e rrezikut nga struktura e sektorit bankar kishte zbritur nën nivelin mesatar, ndërsa pika më e ulët e rrezikut është shënuar në vitin 2016 kryesisht si rezultat i rënies së rrezikut nga devijimi i normës së kapitalizimit të bankave nga norma mesatare e sektorit. Më konkretisht, bankat me normë më të ulët të kapitalizimit kanë rritur kapitalin rregullativ duke konvergjuar drejt normës mesatare të kapitalizimit të sektorit.

Treguesi i mesatarizuar i Kapitalizimit dhe Profitabilitetit karakterizohet me lëvizje të theksuara mbi dhe nën nivelin mesatar të rrezikut (Figura 8).⁵² Vlera e mesatarizuar e treguesit është e lartë në fillim të funksionimit të sektorit, ku edhe siç mund të pritej, sektori karakterizohet me nivel më të ulët të kapitalizimit dhe profitabilitetit. Rreziku i matur përmes këtij treguesi shënon pikën më të ulët në periudhën para krizës globale financiare të vitit 2007-2008, në të cilën periudhë pothuajse të gjithë nëntreguesit sinjalizojnë rrezik të ulët. Kjo tregon se para fillimit të krizës, sektori bankar i Kosovës bazohej në fundamente të shëndosha të cilat bënë që sektori të jetë më i qëndrueshëm ndaj goditjeve të mundshme të krizës. Sidoqoftë, rreziku filloi të rritet në tremujorin e fundit të vitit 2008, duke reflektuar efektet e tërthorta të krizës globale që mund të jenë reflektuar në trendin rritës të kredive joperformuese si dhe efektin e tyre në rënien e të hyrave. Treguesi i kapitalizimit dhe profitabilitetit sinjalizon për rrezik më të lartë në periudhën 2012-2013, që përkon me periudhën e rritjes së kredive joperformuese, rritjen e ekspozimeve të mëdha kreditore dhe rënien e normave të kapitalizimit, ku kjo e fundit u ndikua si nga profitabiliteti më i ulët i bankave në atë periudhë, ashtu edhe nga ndryshimet nga ana e BQK-së në mënyrën e kalkulimit të kapitalit rregullativ.⁵³ Viti 2016 karakterizohet me rrezik mjaft nën mesatare dhe me tendencë rënie, si rezultat i profitabilitetit të lartë të sektorit dhe përmirësimit të cilësisë së portofolios kreditore.


Treguesi i mesatarizuar i Likuiditetit dhe Financimit përgjithësisht karakterizohet me disa oscilime rreziku rreth mesatares historike (figura 9).⁵⁴

Figura 8. Kapitalizimi dhe profitabiliteti



Burimi: BQK (2016)

Figura 9. Likuiditeti dhe financimi



Burimi: BQK (2016)

⁵² Treguesi i mesatarizuar i Kapitalizimit dhe Profitabilitetit, i cili ndërtohet nga gjashtë nëntregues, fillon nga viti 2000 kur edhe datojnë të dhënat e para për sektorin bankar në Kosovë. Deri në vitin 2007, treguesi ndërtohet nga të dhëna të pjesshme, ndërsa nga viti 2008, datojnë të dhënat për të gjithë nëntreguesit.

⁵³ BQK ndryshoi rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, sipas së cilës ndryshoi mënyra e klasifikimit të kapitalit rregullativ të cilin iu zbritën kategori të caktuara, si dhe u bënë ndryshime në strukturën e Mjeteve të Peshuara ndaj Rrezikut të cilave iu shtua pozicioni i 'Rrezikut operacional'.

⁵⁴ Treguesi i mesatarizuar i Likuiditetit dhe Financimit është ndërtohet nga pesë nëntregues dhe fillon nga viti 2001 Treguesi në fillim të periudhës ndërtohet nga të dhënat e pjesshme për shkak se të dhënat për disa nëntregues mungojnë ndërsa disa të tjerë, duke qenë në periudhën konsoliduese të sektorit bankar, japin vlera ekstreme dhe jashtë trendit të përgjithshëm prandaj nuk mund të konsiderohen si pika reale për sinjalizim të rreziqeve. Periudha 2001-2003 reflekton rrezikun vetëm nga nëntreguesi i financimit nga jo-rezidentët. Nga viti 2003 shtohet trendi i depozitave të ekonomive familjare dhe raporti kredi/depozita. Reflektimi i rreziqeve nga të gjithë nëntreguesit fillon vetëm nga viti 2010.

Pika më e ulët e rrezikut u shënua në tremujorin e dytë të vitit 2005, që përkon me normë të lartë të rritjes së depozitave të ekonomive familjare në këtë periudhë, duke reflektuar kështu rritje të likuiditetit të bankave dhe më shumë burime financimi në dispozicion për kreditimin e ekonomisë. Ndërsa, pika më e lartë e rrezikut shënohet në periudhën e fundit TM2 2016, e diktuar kryesisht nga tre nëntreguesit që sinjalizuan rrezik të lartë në këtë periudhë. Megjithatë, pozicioni i përgjithshëm i likuiditeti të sektorit mbetet i kënaqshëm gjykuar nga krahasimi i vlerave të këtyre nëntreguesve me normat referente të raportit të likuiditetit. Rritja e rrezikut mbi mesatare nga nëntreguesi i depozitave të ekonomive familjare përkon më ritmin më të ngadalësuar të rritjes së depozitave që nga viti 2012. Po ashtu, edhe nëntreguesi i raportit kredi/depozita ndikoi në rritjen e rrezikut të likuiditetit mbi nivelin mesatar për shkak të ritmit më të shpejtë të rritjes së kredive krahas rritjes më të ngadalësuar të depozitave. Rreziku i rritur u ndikua edhe nga thellimi i hendekut negativ të likuiditetit për shkak të mospërputhjes së afatit të maturimit në mes të aseteve dhe detyrimeve të intervalit kohor deri në 3 muaj. Thellimi i hendekut negativ erdhi si rezultat i rritjes më të theksuar të kreditimit, nga njëra anë, që ndikoi në rritjen e aseteve të afatit më të gjatë kohor, ndërsa, në anën tjetër, detyrimet pësuan zhvendosje drejt afatit më të shkurtër të maturimit. Kjo si rezultat i ambientit me norma të ulëta të interesit, i cili ndikoi në rritjen e depozitave të transferueshme kundrejt rënies së depozitave të afatizuara.


V.I. Agregimi i treguesve të mesatarizuar të HSF-së

Për qëllime të analizimit të rrezikut të përgjithshëm ndaj stabilitetit financiar, është bërë agregimi i treguesve të veçantë që paraqesin burimet apo dimensionet e ndryshme të rrezikut ndaj stabilitetit financiar (figura 10). Agregimi është bërë përmes mesatares së thjeshtë të tetë treguesve të mësipërm të mesatarizuar.

Rreziku i përgjithshëm ndaj sektorit financiar karakterizohet me luhajtje në intervalin mesatar të rrezikut me notë 4-6, me përjashtim të periudhave të hershme të fillimit të funksionimit të sektorit bankar të cilat sugjerojnë për rrezik më të lartë. Periudha e krizës financiare 2007-2008 karakterizohet me ngritje të lehtë rrezikut mbi nivelin mesatar. Vitet 2011-2014 gjithashtu karakterizohen me nivel të rrezikut mbi mesatare, që korrespondon me periudhën e ngadalësimit të rritjes ekonomike në vend, aktivitet kreditor të

ngadalësuar si dhe përkeqësim të cilësisë së portofolit kreditor dhe normave të kapitalizimit të sektorit. Ndërsa, rreziku në vitet e fundit 2015-2016 tregon tendencë rënëse, me ç' rast viti 2016 shënon ndër vlerat më të ulëta të rrezikut të ndikuar kryesisht nga rënia e rrezikut në treguesit e rrezikut të brendshëm të sektorit, përkatësisht pozita e mirë e kapitalizimi dhe profitabilitetit dhe përmirësimi i strukturës së sektorit, si dhe rreziku i ulët nga ekonomia e jashtme.

Figura 10. Mesatarja e thjeshtë e treguesve të mesatarizuar




Burimi: BQK (2016)

VI. Harta e Stabilitetit – Paraqitja grafike

Në këtë seksion është prezantuar grafiku në formë të diagramit rrjetor i Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës. Prezantimi në këtë formë mundëson komunikimin e çartë të notave të rrezikut për burimet e veçanta të rrezikut ndaj stabilitetit financiar, si dhe krahasimin e tyre për disa periudha kohore.

Në figurën 11. A. paraqitet Harta e Stabilitetit Financiar për dy vitet e fundit, si dhe mesatarja historike e cila reflekton notën mesatare të rrezikut të përgjithshëm për të gjitha periudhat.⁵⁵ Figura sugjeron se rreziku ndaj stabilitetit financiar që buron nga ekonomia e jashtme ka shënuar rënie të lehtë në vitin 2016 si pasojë e rritjes më të lartë të BPV-së së partnerëve tregtarë në TM1 2016 dhe rënies së mëtejme të normave bazë të interesit. Çmimet e naftës ngadalësuan rënien, andaj krahasuar me vitin paraprak shënuan rrezik më të lartë. Në përgjithësi, rreziku për stabilitetin financiar nga ekonomia e jashtme mbetet në nivel të ulët, duke qëndruar mjaft nën nivelin mesatar historik.

Figura 11. A. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK (2016)

Rreziku nga ekonomia e brendshme është zhvendosur drejt qendrës në TM2 2016 duke shënuar rënie. Kjo rënie e rrezikut i atribuohet hendekut më të ulët të BPV-së krahasuar me TM2 2015. Rënie e rrezikut është shënuar edhe nga zhvillimet në kursin valutor që u karakterizuan me më pak luhajtje. Ndërsa, borxhi i jashtëm i Kosovës dhe deficitit i llogarisë rrjedhëse janë rritur. Rreziku nga inflacioni gjithashtu ka treguar tendencë rritëse në TM2 2016 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa rreziku nga ambienti ligjor mbetet në nivel të njëjtë. Përkundër rënies së rrezikut të përgjithshëm në vitin e fundit, ai mbetet në nivel pak më të lartë se niveli mesatar.

Rreziku që buron nga agjentët ekonomik, përkatësisht ekonomitë familjare, ka shënuar ngritje të lehtë në vitin 2016, por që mbetet nën nivelin mesatar historik. Ndërsa, rreziku nga ndërmarrjet dhe qeveria është zhvendosur drejt qendrës duke shënuar rënie. Rritja e rrezikut për ekonomitë familjare buron kryesisht nga remitencat, të cilat po shënojnë rënie që nga TM4 2015. Përmirësime në këtë kategori janë shënuar nga rritja e kreditimit për sektorin e ekonomive familjare si dhe përmirësimi i cilësisë së portofolit kreditor. Ndërmarrjet shënuan rënie të rrezikut kryesisht si rezultat i përmirësimit të theksuar të cilësisë së portofolit kreditor dhe përmirësimit të raportit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të mbyllura. Ndërsa, nëntreguesi i vlerës së shtuar në BPV nga sektori i tregtisë shënoi përkeqësim si rrjedhojë e ngadalësimit të aktivitetit në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë në vitin 2016. Rreziku nga sektori qeveritar ka shënuar rënie duke reflektuar zhvillimet pozitive si zvogëlimi i rrezikut sovran, rënia e deficitit fiskal dhe rritja e raportit të të ardhurave tatimore ndaj BPV-së. Ndërsa, madhësia e borxhit qeveritar ndaj BPV-së si dhe shpenzimet për borxhin kanë shënuar rritje.

⁵⁵ Mesatarja historike përfshinë mesataren e thjeshtë të notave të rrezikut për treguesit e mesatarizuar për të gjitha periudhat.


Rreziku i brendshëm për sektorin bankar, i lidhur me strukturën e sektorit bankar si dhe me nivelin e kapitalizimit dhe profitabilitetit kanë shënuar rënie të theksuar. Rreziku nga struktura e sektorit bankar ka rënë si rezultat i zhvillimeve pozitive në pothuajse të gjithë komponentët e tij, me theks të veçantë në rënieën e rrezikut nga devijimi negativ ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit bankar, që nënkupton se bankat me normë më të ulët të kapitalizimit kanë rritur kapitalin rregullativ duke konvergjuar drejt mesatares së sektorit. Diversifikimi i portfolios së kredisë dhe burimeve të financimit të bankave është rritur, gjithashtu duke kontribuar në rënie të rrezikut. Përderisa koncentrimi i përgjithshëm i tregut ka shënuar rënie, përqendrimi i kredimarrjes ka qëndruar në nivel të njëjtë. Rreziku i lidhur me kapitalizimin dhe profitabilitetin shënoi rënie në TM2 2016 krahasuar me vitin paraprak duke reflektuar përmirësimin e cilësisë së portfoliot kreditor, rënieën e ekspozimeve të mëdha kreditore dhe rritjen e kapitalit aksionar. Ndërsa, komponentët të cilat shënuan ngritje të lehtë të rrezikut janë të hyrat nga interesi, fitimi para taksave si dhe norma e adekuatshmërisë së kapitalit, e cila u zvogëluar si rrjedhojë e rënies së kapitalit të klasit të dytë.

Rreziku i brendshëm i lidhur me likuiditetin dhe financimin e sektorit ka shënuar rritjen më të lartë dhe reflekton rritjen e rrezikut në të gjithë komponentët e tij. Raporti kredi/depozita ka shënuar rritje më të theksuar si rezultat i rritjes më të shpejtë të kreditimit. Rritja e rrezikut është ndikuar edhe nga ngadalësimi i trendit të rritjes së depozitave për ekonomitë familjare, rritja e detyrimeve ndaj jorezidentëve, rritja e theksuar e hendekut të likuiditetit për afatin e maturimit deri në 3 muaj si dhe rënia e raportit të aseteve likuide. Sidoqoftë, duhet theksuar se përkundër rritjes së rrezikut të stabilitetit financiar të lidhur me likuiditetin dhe financimin, që reflekton ngritjen e këtij rrezikut krahas ecures së zhvillimit të tij historik, pozita e likuiditetit të sektorit mbetet e kënaqshme gjykuar në bazë të nivelit të parametrave kryesorë të likuiditetit të cilët janë në nivele mjaft më të favorshme se normat referente dhe niveli minimal i kërkuar me rregullore.⁵⁶

Figura 11. B. paraqet HSF-në në periudhën e krizës globale financiare. Treguesi i Ekonomisë së jashtme duket se reflekton mirë momentet e krizës, me ç'rast rreziku shënon rritje në vitin 2008 si rezultat i përkeqësimit të theksuar të pothuajse të gjithë nëntreguesve. Rreziku në ekonominë e brendshme të Kosovës gjithashtu shënon rritje në vitin 2008, kryesisht si rezultat i ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe rënies së BPV-së nën nivelin potencial.

Ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet shënojnë rënie të rrezikut në periudhën e krizës, kryesisht si rezultat i ngushtimit të hendekut të kredihënies në raport me BPV-në që ka pasuar nga rritja më e shpejtë e kreditimit në vitet paraprake dhe ngadalësimi i rritjes së BPV-së në këtë periudhë, por që rreziku rritet menjëherë në periudhën pasuese. Rreziku nga sektori qeveritar shënon rritje më të theksuar në periudhën e krizës, në vitin 2008 përkatësisht, si rezultat i rritjes së deficitit fiskal. Duhet theksuar se vlerësimi i rrezikut për treguesit e agjentëve ekonomik në këto periudha kohore bazohet në

Figura 11. B. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK (2016)

⁵⁶ Raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra në TM2 2016 ishte 41.5 përqind krahasuar me minimumin prej 25 përqind. Raporti i kredive ndaj depozitave qëndroi në 80 përqind, që është niveli i rekomandueshëm nga BQK.

numër të kufizuar të nëntreguesve (dy nëntregues), ndaj dhe është më e vështirë të analizohet ndërlidhja e tyre me krizën globale të kësaj periudhe.

Treguesit e rrezikut të brendshëm të sektorit bankar gjithashtu bazohen në të dhëna të kufizuara për periudhën e krizës.⁵⁷ Treguesi i Kapitalizimit dhe Profitabilitetit si dhe ai i Likuiditetit dhe Financimit shënojnë rritje të lehtë të rrezikut në vitin 2008. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënon rënie, ndërsa raporti kredi/depozita ngritet si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit. Viti 2009 shënon ngadalësim të theksuar të rritjes së kreditimit, dhe rënie të rrezikut për këta tregues, që mund të jetë efekt i tërthortë i krizës në perceptim të rrezikut dhe gatishmërinë e sektorit për kreditim.

Si përfundim, harta e stabilitetit financiar priret drejtë largimit nga qendra në periudhën e krizës, duke reflektuar rritje të rreziqeve që rrjedhin nga ekonomia reale. Me përfundimin e krizës, në vitin 2009, HSF zhvendoset drejt qendrës si rrjedhojë e rënies së rrezikut. Mirëpo, shkalla e zhvendosjes së HSF-së në të dy rastet është mjaft e ulët, që nënkupton që nuk ka pasur ndonjë lëvizje të theksuar të rrezikut nga pozita e saj fillestare para krizës. Kjo sugjeron se kanalet e transmetimit të krizës në ekonominë e Kosovës dhe sektorin bankar kanë qenë të limituara. Kriza globale është ndjerë më pak në vendet me të cilat Kosova ka më shumë bashkëpunim tregtar dhe koncentrim të diasporës, ndaj dhe kjo shpjegon efektin e ulët të krizës në zhvendosjen e treguesve të ekonomisë reale. Gjithashtu, ekspozimi i drejtpërdrejtë, megjithëse i ulët, i sektorit bankar në instrumente të sigurta në sektorin e jashtëm, kryesisht depozita dhe letra me vlerë të qeverive të huaja, ka kontribuar në stabilitet. Prandaj, pozita e kapitalizimit dhe profitabilitetit të sektorit mbetet në nivel pothuajse të njëjtë gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar të Kosovës përgjatë kësaj periudhe.

⁵⁷ Për treguesin e Strukturës së sektorit bankar, në mungesë të dhënave, viti 2007 TM4 reflekton të dhënat e periudhës 2008 TM2.

VII. Përfundim

Harta e Stabilitetit Financiar (HSF) për Kosovën synon të prezantoj në mënyrë grafike dhe lehtësisht të kuptueshme burimet kryesore të rreziqeve të jashtme dhe të brendshme ndaj sektorit bankar dhe stabilitetit financiar në Kosovë, si dhe ndryshimin e tyre gjatë disa periudhave kohore. Kontributi i HSF-së qëndron në mundësimin e analizimit të njëkohshëm të dimensioneve të ndryshme të brishtësive dhe rreziqeve ndaj stabilitetit financiar, duke ruajtur njëkohësisht karakteristikën e gjithë-përfshirjes dhe paraqitjes së agreguar të rrezikut ndaj stabilitetit financiar.

Modeli i HSF-së do të inkorporohet në publikimin e rregullt të Raportit të Stabilitetit të Kosovës, duke filluar nga edicioni i 10-të, si vegël për diskutimin e ecurisë së rreziqeve kryesore ndaj stabilitetit financiar të sektorit bankar. Përditësimi në mënyrë sistematike i HSF-së synon të ngritë nivelin e analizës dhe komunikimit të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar.

Rezultatet e modelit të hartës së stabilitetit të Kosovës sugjerojnë për trend rënës të rrezikut të përgjithshëm ndaj sektorit financiar. Rreziku lëvizë në intervalin mesatar, me përjashtim të periudhave të hershme të fillimit të funksionimit të sektorit bankar të cilat sugjerojnë për rrezik më të lartë. Periudha e krizës financiare 2007-2008 karakterizohet me ngritje të lehtë të rrezikut mbi nivelin mesatar. Vitet 2012-2014 gjithashtu karakterizohen me rrezik mbi mesatare, ndërsa, nga TM4 2012 rreziku tregon tendencë rënëse, me ç' rast viti 2016 shënon ndër vlerat më të ulëta të rrezikut. Rreziku më i ulët në vitin 2016 i atribuohet kryesisht nivelit të ulët të rrezikut të brendshëm të sektorit, përkatësisht treguesit të strukturës së sektorit bankar si dhe atij të kapitalizimit dhe profitabilitetit, si dhe rrezikut nga ekonomia e jashtme, i cili po qëndron në nivel mjaft më të ulët se mesatarja historike. Rreziku nga ekonomia e brendshme, megjithëse mbetet pak mbi mesataren historike, ka shënuar gjithashtu rënie.

Performanca e përgjithshme e HSF-së në sinjalizimin e krizave është e limituar për shkak të serive të shkurtra kohore të shumë prej treguesve. Sidoqoftë, treguesit të cilët kanë shtrirje edhe në periudhën e para krizës globale të vitit 2008 duket të reflektojnë mirë momentin e kësaj krize dhe ndikimin e saj marginal në ekonominë e Kosovës dhe sektorin financiar. Ndërsa, sa i përket performancës së HSF-së në sinjalizimin e rreziqeve në kohë reale, kemi disa kufizime për shkak të vonesës së disa prej të dhënave të cilat publikohen në baza vjetore ose me vonesa disa mujore. Kufizimet tjera në të dhëna përfshijnë mbështetjen shumë të madhe në të dhëna të karakterit historik, përderisa synimi duhet të jetë në përfshirjen sa më të madhe të treguesve me të dhëna të karakterit parashikues që kontribuojnë në identifikimin e akumulimit të rreziqeve për të ardhmen.

Performanca e HSF-së, përveç kualitetit të dhënave, mund të ndikohet gjithashtu nga për zgjedhja e nëntreguesëve të përfshirë. Në këtë kontekst, prezantimi i modelit fillestar të HSF-së synon të nxisë diskutim që mund të sjellë përmirësime eventuale në kualitetin e treguesëve të përfshirë dhe kontributin e tyre në sinjalizimin e rreziqeve. Gjithashtu, mjedisi financiar ka karakter shumë dinamik dhe modeli i HSF-së duhet të avancohet në vazhdimësi në mënyrë që të reflektojë dinamikën dhe zhvillimet e vazhdueshme në sektorin financiar.

Puna në përmirësimin e kualitetit të HSF-së në të ardhmen, ndër tjera, mund të fokusohet në përfshirjen dhe vlerësimin e treguesëve me karakter më afatgjatë që mund të sinjalizojnë për akumulim të rreziqeve të sektorit bankar. Një aspekt tjetër që duhet të konsiderohet është përcaktimi i vlerave referente të rrezikut për nëntreguesit, në mënyrë që të mundësohet

vlerësimi 'absolut' i rrezikut në një periudhë kohore dhe jo vetëm ndryshimi i rrezikut në raport me historikun e tij.

11. Referencat

Agjencia e Statistikave të Kosovës, www.ask.rks-gov.net

Andersen, H. (2008). Failure prediction of Norwegian banks: a logit approach. *Working paper No.2*, Norges Bank.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, www.bqk-kos.org

Banka Botërore, www.worldbank.org

Bedford, P. and Bloor, C. (2009). A cobweb model of financial stability in New Zealand. *Discussion paper Series No.11*, Reserve Bank of New Zealand.

Berger, A. N., Klapper, L. F., and Turk-Ariss, R. (2009). Bank competition and financial stability. *Journal*

of Financial Services Research, 35: 99-118.

BIS (2016). 86th Annual report, 1 april 2015 - 31 march 2016. Bank for International Settlements.

Borio, C. and Drehmann, M. (2009). Assessing the risk of banking crises – revisited. *BIS Quarterly Review March 2009*, p.29-46, Bank for International Settlements.

Dahl, G. A., Kloster, T. B., Larsen, U., Rakkestad, K. J., Reisvaag, R., Syversten, B. D., and Træe, C. B. (2011). A cobweb model of financial stability in Norway. *Staff Memo No. 15*, Norges Bank.

Dattels, P., McCaughrin, R., Miyajima, K., and Puig, J. (2010). Can you map global financial stability? *Working paper No. 145*, International Monetary Fund.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, www.imf.org/en/data

Freedom House, (2016). Nations in Transit, Kosovo.

Gadanecz, B. and Jayaram, K. (2009). Measures of financial stability – a review. *IFC Bulletin No. 31*, Bank for International Settlements.

Hanschel, E. and Monnin, P. (2002). Measuring and forecasting stress in the banking sector: evidence from Switzerland. *BIS Paper No.22*, p. 431-449, Bank for International Settlements.

Holló, D., Kremer, M., and Lo Duca, M. (2012). CISS – A composite indicator of systemic stress in the financial system. *Working paper series No. 1426*, European Central Bank.

Illing, M. and Liu, Y. (2003). An index of financial stress for Canada. *Working Paper No. 14*, Bank of Canada.

IMF (2007). Global Financial Stability Report. Market Developments and Issues April 2007.

Lielkalne, O. and Sinenko, N. (2015). Cobweb diagram as a tool for assessing changes in the most important financial stability risks. *Discussion paper No. 1*, Latvijas Banka.

Ministria e Financave të Republikës së Kosovës, www.mf.rks-gov.net

Mishkin, F. S. (1999). Financial consolidation: dangers and opportunities. *Journal of Banking and Finance* 23: 675-691.

OECD, Composite Leading Indicators (MEI), www.stats.oecd.org

Reinhart, C., Goldstein, M., and Kaminsky, G. (2000). Assessing financial vulnerability, an early

warning system for emerging markets: introduction. *MPRA Paper* No.13629.

Riiser, M. D. (2012). Asset prices, investment, credit and financial vulnerability. An analysis using quarterly figures. *Economic Commentaries* No.6, Norges Bank.

Saqe, A., Minka, O., dhe Kota, V. (2015). Harta e stabilitetit financiar në Shqipëri. *Revista Ekonomike 6M1* 2015, Banka e Shqipërisë.

Sarlin, P. and Peltonen, T. A. (2011). Mapping the state of financial stability. *Working paper series No.1382*, European Central Bank.

Van den End, J. W. (2006). Indicator and boundaries of financial stability. *Working paper No. 97*, (3), De Nederlandsche Bank.

Worrell, D. (2004). Quantitative assessment of the financial sector: an integrated approach. *Working Paper No. 153*, International Monetary Fund.

Shtojca A. Nëntreguesit dhe metodologjia e ndërtimit të tyre

Tabela. 1. A. Nëntreguesit dhe metodologjia e ndërtimit të tyre

Treguesit	Përshkrimi	Burimi i të dhënave	Data e fillimit të serisë kohore*	Metoda e kalkulimit
1. EKONOMIA E JASHTME				
1.1. Norma e rritjes reale të Bruto Produktit Vendor të partnerëve kryesorë tregtarë	Mesatarja e peshuar e BPV-së të 8 vendeve ku shkojnë rreth 70% të eksporteve. Kalkulimi është bërë duke mbledhur produktin në mes të BPV-së dhe volumit tregtar të secilit nga 8 shtetet e përfshira në këtë nëntregues	Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)	Baza Kuartale: TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit: Normë e lartë, rrezik i ulët
1.2. Norma e ponderuar e papunësisë së vendeve me numër më të madh të diasporës kosovare	Norma mesatare e ponderuar e papunësisë së vendeve prej të cilave vijnë rreth 70% e dërgesave të emigrantëve. Kalkulimi është bërë duke mbledhur produktin në mes të normës së papunësisë së 4 vendeve të përfshira me peshën e tyre në gjithsej dërgesat	FMN Banka Qendrore e Kosovës (BQK)	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit: Normë e lartë, rrezik i lartë
1.3. Çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare	Rritja vjetore e mesatares tremujore të indeksit të çmimit të naftës Crude Oil (2005=100)	Banka Botërore	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit
1.4. Indeksi kryesorë i përbërë i OECD Europe	Mesatarja tremujore e indeksit të përbërë të OECD (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim): OECD Europe.	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD)	TM1 2005	METODË ALTERNATIVE-racionalizim Ndarja e intervalit në pjesë të barabarta. Kahje e zhdrejtë e notimit
1.5. Norma mesatare e LIBOR dhe EURIBOR 3 mujorë	Mesatarja e thjeshtë e mesatarave tremujore të normave LIBOR-EURIBOR me maturitet 3 mujorë, që të dyja në euro	FedprimeRate.com dhe global-rates.com	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit
2. EKONOMIA E BRENDSHME				
2.1. Hendeku i prodhimit	Diferenca e rritjes aktuale të BPV-së në raport me potencialin e rritjes, e kalkuluar me filterin Hodrick-Prescott	ASK dhe BQK	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
2.2. Madhësia e borxhit të jashtëm	Raporti i stokut të borxhit të jashtëm ndaj BPV-së vjetore	BQK ASK Ministria e Financave	TM1 2007	METODË ALTERNATIVE-racionalizim Kufizimi i intervalit me nota nga 3-6. Pjesa e mbetur e intervalit ndahet në pjesë të barabarta. Kahje e drejtë e notimit
2.3. Bilanci i llogarisë rrjedhëse	Raporti i bilancit të llogarisë rrjedhëse ndaj BPV-së vjetore	BQK	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
2.4. Lulahshmëria e kursit të këmbimit	Indeksi i Normës Reale Efektive të Këmbimit që paraqet ndryshimet e valutës euros ndaj vendeve të CEFTA-së dhe BE-së, në terma realë. Seria kohore është mstarizuar dhe transformuar në terma të rritjes vjetore për të evidentuar momentet kryesore të mbiçmimit (nënçmimit) të valutës.	BQK	TM1 2008	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
2.5. Indeksi i çmimeve të konsumit – Inflacioni	Ndryshimi vjetor i mesatares tremujore të indeksit të çmimeve të konsumit, (2015=100)	ASK	TM2 2003	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit
2.6. Kualiteti i institucioneve gjyqësore	Indeksi i Freedom House për Kornizën Ligjore dhe pavarësinë e gjyqësorit me nota 1-7 është transformuar në nota rreziku 0-10.	Freedom House	Viti 2007 (të dhënat vjetore)	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit

* Për disa variabla, të dhënat në vitet e para të fillimit të serisë kohore janë në baza vjetore, të cilat në periudha më të vona raportohen në baza kuartale. Për kompletimin e serisë kohore me të dhëna kuartale, është përdorur metoda e interpolimit, 'cubic spline' dhe mesatares historike të pjesëmarrjes së kuartaleve përkatës në gjithsej shumën vjetore.

Tabela 1. B. Nëntreguesit dhe metodologjia e ndërtimit të tyre

Treguesit	Përshkrimi	Burimi i të dhënave	Data e fillimit të serisë kohore*	Metoda e kalkulimit
3. EKONOMITË FAMILJARE				
3.1. Huamarrja e ekonomive familjare	Diferenca e raportit aktual dhe atij potencial të kredive për ekonomitë familjare ndaj BPV-së vjetore. Kalkulimi përmes filterit Hodrick-Prescott.	BQK dhe ASK	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
3.2. Cilësia e portfolios së kredisë	Raporti i kredive joperformuese të ekonomive familjare ndaj gjithsej kredive për këtë sektorë	BQK	TM4 2011	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufizimi i intervalit me nota nga 4-6, pjesa e mbetur e intervalit ndahet në pjesë të barabarta. Kahje e drejtë e notimit
3.3. Norma e papunësisë	Norma e papunësisë (në %)	ASK	Viti 2001 (Interpolimi i të dhënave për shndërrimin e tyre në të baza kuartale)	METODA ALTERNATIVE Seria kohore është ndarë në 11 intervale ashtu që kufiri i sipërm maksimal i rrezikut me notë 10 përkon me normën maksimale të papunësisë të shënuar në Kosovë, ndërsa intervalet tjera janë përcaktuar duke ia zbritur nga një devijim standard intervalit paraprak. Kahje e drejtë e notimit
3.4. Dërgesat e emigrantëve	Ndryshimi vjetor i shumës tremujore të dërgesave të emigrantëve	BQK	TM1 2010	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
3.5. Përballueshmëria e pagesave të rregullta	Treguesi i numrit të ekonomive familjare të cilat dy herë apo më shumë kanë hasur pengesa në pagesën e shpenzimeve të rregullta (qiraja, kreditë, tatimet, shpenzimet komunale, etj.), e marrë nga Anketa e buxhetit të Ekonomive Familjare të ASK-së.	ASK	Viti 2012 (Interpolimi i të dhënave për shndërrimin e tyre në të baza kuartale)	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufizimi i intervalleve me nota nga 5-8, intervalet e mbetura janë të ndara në pjesë të barabarta. Kahje e drejtë e notimit
4. NDËRMARRJET				
4.1. Huamarrja e ndërmarrjeve	Diferenca e raportit aktual dhe atij potencial të kredive për ndërmarrjet ndaj BPV-së së vjetore. Kalkulimi përmes filterit Hodrick-Prescott.	BQK dhe ASK	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
4.2. Cilësia e portfoliit kreditor të ndërmarrjeve.	Raporti i kredive joperformuese të ndërmarrjeve ndaj gjithsej kredive për këtë sektorë	BQK	TM4 2011	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufizimi i intervalleve me nota nga 4-8, intervalet e mbetura janë ndarë në pjesë të barabarta Kahje e drejtë e notimit
4.3. Indeksi i qarkullimit industrial	Indeksi i qarkullimit industrial, i kalkuluar nga ASK, përfshinë: industrinë nxjerrëse, industrinë përpunuese, furnizim me rrym, gaz, avull..., dhe veprimtarinë e menaxhimit të mbeturinave. Për HSF, është marrë mesatarja e thjeshtë e kater indikatorëve që perbejnë indeksin e qarkullimit industrial	ASK	TM4 2012	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufizimi i intervalit me nota nga 4-8, intervalet e mbetura janë të ndara në pjesë të barabarta Kahje e zhdrejtë e notimit
4.4. Vlera e shtuar në sektorin e tregtisë	Norma reale e rritjes vjetore të vlerës së shtuar në BPV në e vendit nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë.	ASK	TM1 2014	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufizimi i intervalit me nota nga 3-7, intervalet e mbetura janë të ndara në pjesë të barabarta Kahje e zhdrejtë e notimit
4.5. Ecuria e ndërmarrjeve të reja dhe të mbyllura	Diferenca në mes të numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të mbyllura	ASK	TM1 2004	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit

* Për disa variabla, të dhënat në vitet e para të fillimit të serisë kohore janë në baza vjetore, të cilat në periudha më të vona raportohen në baza kuartale. Për kompletimin e serisë kohore me të dhëna kuartale, është përdorur metoda e interpolimit, 'cubic spline' dhe mesatares historike të pjesëmarrjes së kuartaleve përkatës në gjithsej shumën vjetore.

Tabela 1. C. Nëntreguesit dhe metodologjia e ndërtimit të tyre

Treguesit	Përshkrimi	Burimi i të dhënave	Data e fillimit të serisë kohore*	Metoda e kalkulimit
5. QEVERIA				
5.1. Madhësia e borxhit publik	Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së vjetore	Ministria e Financave të Kosovës	TM1 2009	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufiri i sipërm maksimal i rrezikut me notë 10 përkon me normën maksimale të borxhit publik ndaj BPV-së të lejuar me ligj (40%) ndërsa intervalet tjera janë ndarë proporcionalisht deri në 0% (nota 0) Kahje e drejtë e notimit
5.2. Kosto e borxhit	Raporti i shpenzimeve të qeverisë për pagesën e interesit ndaj gjithsej borxhit publik	Ministria e Financave të Kosovës	TM1 2009	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit
5.3. Rreziku sovran	Dallimi i normës 3 mujore të interesit të bonove të thesarit të vendit ndaj atyre gjermane	BQK dhe Bloomberg	TM1 2012	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufizimi i intervalit me nota nga 2-6, intervalet e mbetura janë të ndara në pjesë të barabarta. Kahje e drejtë e notimit
5.4. Bilanci buxhetor i qeverisë	Raport i diferencës së të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore ndaj BPV-së vjetore	Ministria e Financave të Kosovës	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
5.5. Të ardhurat tatimore	Raport i të ardhurave tatimore ndaj BPV-së vjetore	Ministria e Financave të Kosovës	TM1 2005	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
6. STRUKTURA E SEKTORIT BANKAR				
6.1. Koncentrimi i tregut të sektorit bankar	Raport i shumës së asetëve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithsej asetëve të sektorit bankar	BQK	TM1 2008	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Përcaktimi i kufijve për intervalin e rrezikut: për koncentrimin bankar 0-30% caktohet kufiri minimal i rrezikut me notë 0; mbi 80% caktohet kufiri maksimal i rrezikut me notë 10; intervalet e ndërmjetme janë të ndara në pjesë të barabarta. Kahje e drejtë e notimit
6.2. Koncentrimi i kredihënies për sektorin ndërmarrjeve	Raport i kreditimit për ndërmarrje nga banka me pjesëmarrjen më të lartë të kredive të ndërmarrjeve ndaj shumës së kreditimit për ndërmarrje të katër bankave të radhës me pjesëmarrjen më të lartë	BQK	TM1 2010	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Për koncentrimin nën 10% përcaktohet nota e rrezikut minimal 0, ndërsa për atë mbi 100% rreziku maksimal me notën 10. Intervali i ndërmjetëm ndahet në pjesë të barabarta. Kahje e drejtë e notimit
6.3. Devijimi i strukturës së kreditimit të bankave ndaj strukturës së tregut	Portofoli i kredisë së secilës bankë si dhe sektorit bankar është ndarë në tre nëngrupe kryesore: (1) kredia ndaj sektorit privat, (2) kredia ndaj sektorit publik, (3) kredia ndaj ekonomive familjare, të shprehura si pesha në përqindje ndaj totalit të sektorit bankar. Më pas është ndërtuar seria e devijimeve (ndryshimit) midis strukturës së kredisë së secilës bankë dhe strukturës së kredisë të sektorit bankar, dhe është llogaritur varianca e këtyre diferencave duke u bazuar në pjesëmarrjen e kreditimit të secilës bankë në gjithsej kreditimin e sektorit.	BQK	TM1 2010	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufiri i intervalit me nota nga 4-6, intervalet e mbetura janë të ndara në pjesë të barabarta. Kahje e zhdrejtë e notimit
6.4. Devijimi i strukturës së fondeve të bankave ndaj strukturës së tregut	Burimet e financimit janë ndarë në 6 nëngrupe, përjashtuar burimet vetanake, për totalin e sektorit bankar dhe për secilën bankë në veçanti: 1. Bilanci nga bankat komerciale; 2. Depozitat e transferueshme; 3. Depozita e afatizuara; 4. Depozita e kursimeve; 5. Borxhi i ndërruar; 6. Huazimet tjera. Pastaj ndërtohen diferencat midis strukturës së burimeve të financimit të shprehura në përqindje midis secilës bankë dhe strukturës së gjithsej burimeve të financimit të sektorit bankar, dhe llogaritet varianca e këtyre dallimeve duke u bazuar në pjesëmarrjen e fondeve të financimit të secilës bankë në gjithsej financimin e sektorit bankar.	BQK	TM1 2010	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Kufiri i intervalit me nota nga 4-6, intervalet e mbetura janë ndarë në pjesë të barabarta. Kahje e zhdrejtë e notimit
6.5. Devijimi i normës së kapitalizimit të bankave ndaj normës së kapitalizimit të gjithsej sektorit	Varianca e ndryshimit midis normës së mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave individuale ndaj mesatares së sektorit bankar, vetëm për ato banka që ndodhen poshtë nivelit të sektorit bankar. Varianca është llogaritur e ponderuar duke marrë parasysh peshën e asetëve të secilës bankë ndaj gjithsej asetëve të sektorit.	BQK	TM1 2008	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit

* Për disa variabla, të dhënat në vitet e para të fillimit të serisë kohore janë në baza vjetore, të cilat në periudha më të vona raportohen në baza kuartale. Për kompletimin e serisë kohore me të dhëna kuartale, është përdorur metoda e interpolimit, 'cubic spline' dhe mesatares historike të pjesëmarrjes së kuartaleve përkatës në gjithsej shumën vjetore.

Tabela 1. D. Nëntreguesit dhe metodologjia e ndërtimit të tyre

Treguesit	Përshkrimi	Burimi i të dhënave	Data e fillimit të serisë kohore*	Metoda e kalkulimit
7. KAPITALIZIMI DHE PROFITABILITETI				
7.1. Mjaftueshmëria e kapitalit rregullativ	Diferenca ndërmjet normës aktuale të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar dhe normës minimale të lejuar sipas rregullores	BQK	TM4 2003	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
7.2. Kapitali aksionar I sektorit	Raporti i burimeve vetanake (ekuitetit) ndaj gjithsej asetëve të sektorit	BQK	TM4 2000	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
7.3. Kreditë joperformuese të sektorit	Raporti i kredive joperformuese të sektorit ndaj gjithsej kredive bruto	BQK	TM1 2007	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit
7.4. Të ardhurat neto nga interesi	Raporti i të ardhurave neto nga interesi ndaj gjithsej asetëve	BQK	TM4 2000	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
7.5. Profitabiliteti i sektorit	Raporti i fitimit para tatimit ndaj gjithsej asetëve	BQK	TM4 2000	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
7.6. Ekspozimet e mëdha	Raporti i ekspozimeve të mëdha, sipas përkufizimit të rregullores së BQK-së mbi Ekspozimet e Mëdha, ndaj kapitalit të klasit të parë.	BQK	TM1 2008	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit
8. LIKUIDITETI DHE FINANCIMI				
8.1. Mbulueshmëria e kredive me depozita	Raporti i gjithsej kredive të sektorit bankar ndaj gjithsej depozitave të sektorit	BQK	TM1 2003	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit
8.2. Depozita e ekonomive familjare	Norma vjetore e rritjes tremujore të depozitave të ekonomive familjare	BQK	TM2 2003	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e zhdrejtë e notimit
8.3. Detyrimet ndaj jo-rezidentëve	Raporti i detyrimeve ndaj jorezidentëve ndaj gjithsej burimeve të financimit	BQK	TM1 2001	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Mesatarja e serisë kohorë është vlerësuar me notën 5. Pastaj çdo interval mbi mesatare është shtuar vlera e devijimit standard, ndërsa çdo interval nën mesatare është zvogëluar për atë vlerë të devijimit standard. Kahje e drejtë e notimit
8.4. Raporti i likuiditetit	Raporti i asetëve likuide (deri në 3 muaj) ndaj detyrimit afatshkurtëra (deri në 1 vit).	BQK	TM1 2008	METODA ALTERNATIVE-racionalizim Vendoset taveni i poshtëm minimal prej 25% (e vlerësuar me notë rreziku 10), dhe maksimal prej 50% (e vlerësuar me notë rreziku 0) ndërsa intervalet ndërmjet 25% - 50% janë ndarë në nëntë pjesë të barabarta. Kahje e zhdrejtë e notimit
8.5. Hendeku i likuiditetit	Diferencë në mes të asetëve afatshkurtëra deri në 3 muaj dhe detyrimeve afatshkurtëra deri në 3 muaj	BQK	TM1 2010	METODA STANDARDE 0-10 Kahje e drejtë e notimit

* Për disa variabla, të dhënat në vitet e para të fillimit të serisë kohore janë në baza vjetore, të cilat në periudha më të vona raportohen në baza kuartale. Për kompletimin e serisë kohore me të dhëna kuartale, është përdorur metoda e interpolimit, 'cubic spline' dhe mesatares historike të pjesëmarrjes së kuartaleve përkatës në gjithsej shumën vjetore.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +381 38 222 055; Fax: +381 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org